



**QKSS**

Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë

**RAPORTI PËR VLERËSIMIN BAZË TË DHUNËS NË BAZA  
GJINORE NË KOSOVË:**

**PERCEPTIMET E KOMUNITETIT  
DHE PALËVE TË INTERESIT**



**GPS**  
Gender,  
Peace, and  
Security  
Programme



**QKSS**  
Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë

Autore:

Teuta Avdimetaj

Hulumtuese:

Dea Fetiu, Dorjeta Rukiqi

Rishikuar nga:

Rita Berisha

**RAPORTI PËR VLERËSIMIN BAZË TË DHUNËS NË BAZA  
GJINORE NË KOSOVË:**

# **PERCEPTIMET E KOMUNITETIT DHE PALËVE TË INTERESIT**

Dhjetor 2022

# TABLE OF CONTENTS

---

Akronime .....	1
Përmbledhje ekzekutive .....	2
Hyrje dhe konteksti.....	8
Korniza ligjore dhe hartëzimi i palëve të interesit .....	14
Metodologjia .....	16
Gjetjet kyçe .....	16
Të dhënat dhe trendet e raportimit për dhunën në baza gjinore .....	16
Procesi i trajtimit të rasteve të dhunës në baza gjinore: sfidat dhe kufizimet .....	16
Perceptimet për faktorët që ndikojnë në dhunën në baza gjinore (DHBGJ) në Kosovë .....	16
Perspektivat për rehabilitim dhe riintegrim për të mbijetuarat e dhunës në baza gjinore .....	16
Rekomandime .....	28
Përfundime .....	30
Referencat .....	31

# AKRONIME

---

**QPS** Qendrat për Punë Sociale

---

**BE** Bashkimi Evropian

---

**DGF** Diskutime në Grup të Fokusit

---

**DHBGJ** Dhuna në Baza Gjinore

---

**QK** Qeveria e Kosovës

---

**DHPI** Dhuna nga Partneri Intim

---

**IIK** Intervista me Informues Kyç

---

**QKSS** Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë

---

**PK** Policia e Kosovës

---

**MFPT** Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve

---

**OJQ** Organizatë Joqeveritare

---

**DHSBGJ** Dhuna Seksuale dhe në Baza Gjinore

---

**PSV** Procedura Standarde e Veprimit

---

**OKB** Organizata e Kombeve të Bashkuara

---

**UNODC** Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin

---

**OSBE** Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë

---

# PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

---

Ky raport ofron një vlerësim bazë të dhunës në baza gjinore (DHBGJ) në Kosovë, me fokus në eksplorimin e trendeve dhe sfidave kyçe bazuar në këndvështrimet e komunitetit dhe të palëve të interesit. Raporti mbështetet kryesisht në të dhënat e mbledhura përmes intervistave me informues kyç (IIK) dhe diskutimeve në grupe të fokusit (DGF) ku u morën njohuri nga komunitetet e prekura gjatë artikulimit prej tyre të pranisë së kërcënimit, faktorëve që ndikojnë në përhapjen e fenomenit, dhe mënyrës se si ata e konsiderojnë duhet të jetë qasja për adresimin e tij. Edhe pse korniza ligjore dhe strategjike për dhunën në baza gjinore konsiderohet e avancuar dhe kryesisht në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe rregulloret e BE-së, mungesa e financimit adekuat dhe normat patriarkale të rrënjësura thellë në shoqërinë e Kosovës e bëjnë të vështirë zbatimin e këtyre ligjeve në praktikë.

Përderisa edhe burrat mund të jenë të mbijetuar të dhunës në baza gjinore, në Kosovë gratë vazhdojnë të preken në mënyrë disproporcionale nga fenomeni, pasi më shumë se 85 për qind të rasteve të dhunës në baza gjinore ushtrohet ndaj grave. Viteve të fundit të fundit ka pasur një rritje të vazhdueshme të rasteve të raportuara të dhunës në baza gjinore, duke përfshirë një rritje gjatë pandemisë COVID-19, kur janë raportuar gjithsej 2,069 në Policinë e Kosovës, ose 155 raste më shumë se në vitin pararendës.<sup>1</sup> Megjithatë, shumica e të anketuarve konsiderojnë se rritja e rasteve të raportuara korrespondon me nivelet më të larta të vetëdijesimit për raportimin e dhunës sesa me ndryshimin e trendeve në prevalencën e problemit. Në fakt, shumë të anketuar e shohin çështjen e dhunës në baza gjinore si një problem që nuk raportohet sa duhet, marrë parasysh se ka ende mungesë të gjerë të vetëdijesimit, veçanërisht në mesin e të mbijetuarave të dhunës në baza gjinore me origjinë nga zonat rurale, të cilat kanë qasje më të kufizuara në informacion mbi të drejtat e tyre dhe disponueshmërinë e shërbimeve mbështetëse.

Megjithëse dhuna në baza gjinore mund të marrë shumë forma, ndër manifestimet e saj më të përhapura përfshihen dhuna në familje, ngacmimi seksual dhe dhuna seksuale. Së fundmi, dhuna psikologjike dhe dhuna ekonomike janë raportuar si raste të dhunës në baza gjinore në Kosovë. Megjithatë, një nga trendet më alarmuese në manifestimin e dhunës në baza gjinore janë rastet e femicidit ose vrasjes së grave për shkak se janë gra, zakonisht nga duart e partnerit, bashkëshortit aktual ose ish-bashkëshortit. Kjo çështje rëndohet duke qenë se shumica e rasteve të femicidit përfshijnë kryes recidivistë, të cilët sistemi i drejtësisë nuk ka arritur t'i filtrojë për të garantuar mbrojtjen e të mbijetuarave dhe për të parandaluar vrasjen e tyre. Rastet e femicidit dhe dështimet flagrante në reagimin institucional e kanë galvanizuar shoqërinë kosovare, dhe shumë qytetarë e aktivistë të të drejtave të njeriut po protestojnë që çështja të trajtohet më seriozisht dhe t'i jepet prioritet si emergjencë kombëtare.

Përkundër faktit se legjislacioni i Kosovës shihet si progresiv dhe garantues i barazisë ndërmjet gjinive, në realitet, gratë në Kosovë vazhdojnë të jenë të nënperfaqësuar në pozita vendimmarrëse, u mungojnë mundësitë e barabarta për arsimim dhe punësim

---

1 Të dhëna të dorëzuara në Qendrën Kosovare për Studime të Sigurisë nga Policia e Kosovës

formal, kanë shkallë të ulët të pronësisë. Këta janë disa nga faktorët që të anketuarit i konsiderojnë si kritikë kur flitet për riskun më të madh të grave për të përjetuar DHBGJ.

Sipas të dhënave të anketës të marra përmes Barometrit të Sigurisë në Ballkanin Perëndimor, rreth 45 për qind e të anketuarve e shohin dhunën në familje si risk ose risk i lartë për komunitetet e tyre.<sup>2</sup> Një nivel më i lartë i të anketuarve, ose 54 për qind, i shohin ngacmimet seksuale si risk ose risk i lartë për komunitetet e tyre.<sup>3</sup> Nga ana tjetër, rreth 46 për qind e të anketuarve e konsiderojnë diskriminimin në baza gjinore si risk apo risk i lartë për komunitetet e tyre.

Ky raport identifikon se rastet e raportuara të DHBGJ-së janë rritur gjatë vitit të kaluar krahas kërkesave për urdhra të mbrojtjes të shqiptuar nga gjykata për të mbijetuarat. Megjithatë, të mbijetuarat e DHBGJ-së përballen me barriera në raportimin e rasteve të tyre, duke përfshirë informacionin e kufizuar për të drejtat dhe disponueshmërinë e shërbimeve mbështetëse, stigmën sociale, mungesën e besimit në institucionet shtetërore, dhe kërcënimet nga dhunuesit. Më tej, shkeljet e parimeve të konfidencialitetit të shoqëruara me burokraci dhe procedura të gjata juridike, ndikojnë negativisht në nivelet e raportimit të rasteve të dhunës në familje. Normat tradicionale dhe përpjekjet për ndërmjetësim familjar ndërmjet dhunuesve dhe të mbijetuarave të dhunës në familje e ndërlikojnë raportimin për DHBGJ-në dhe reagimin rezultues institucional.

Mungesa e financimit të qëndrueshëm për strehimoret për të mbijetuarat e dhunës në familje vazhdon ta sfidojë reagimin institucional, ndërkohë që shqetësim kryesor mbetet pandëshkueshmëria rreth rasteve të DHBGJ-së dhe dështimet e mbrojtjes institucionale, të cilat çojnë në përshkallëzimin e rasteve recidiviste në femicid. Çështja rëndohet edhe më tej nga qëndrimet problematike të punëtorëve të vijës së parë të karakterizuar nga paragjykimet ndaj të mbijetuarave dhe qëndrimet arsyetuese të dhunës nga institucionet e sigurisë dhe prokuroria. Teksa roli i OSHC-ve konsiderohet kritik për të ndihmuar në mbushjen e hendekëve ekzistues në ofrimin e shërbimeve, ekzistojnë programe dhe kapacitete të kufizuara riintegrimi për të siguruar një qasje më afatgjatë për adresimin e rasteve të DHBGJ-së dhe lehtësimin e tranzicionit të sigurt të të mbijetuarave në shoqëri.

Ndër rekomandimet kyçe që rrjedhin nga ky studim përfshihen nevoja e zbatimit të fushatave për vetëdijësim në lidhje me kërcënimin e DHBGJ-së, mënyrën e raportimit të saj dhe ku mund të kërkojnë ndihmë të mbijetuarat e DHBGJ-së; dhënia fund pandëshkueshmërisë për kryesit e DHBGJ-së dhe ata që kryejnë krime të DHBGJ-së duhet të përballen me dënime më të ashpra. Për më tepër, të anketuarit kanë rekomanduar që rastet recidiviste duhet të trajtohen më seriozisht, duke përfshirë programet e rehabilitimit për të ulur potencialisht riskun e tyre për përsëritje të veprës.

---

2 "Barometri i Sigurisë në Ballkanin Perëndimor", 2022. Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë.

3 Po aty.

# HYRJE DHE KONTEKSTI

---

Dhuna në baza gjinore (DHBGJ) ose ndonjëherë e referuar edhe si dhuna seksuale dhe në baza gjinore (DHSBGJ) është "çdo akt i dëmshëm i keqtrajtimit seksual, fizik, psikologjik, mendor dhe emocional që kryhet kundër vullnetit të një personi dhe që bazohet në dallimet e caktuara shoqërore (d.m.th. gjinore) mes burrave dhe grave."<sup>4</sup> Kjo është një sfidë globale që prek shoqëritë në mbarë botën, duke paraqitur një shkelje të rëndë të të drejtave të njeriut e cila përveçse shkakton vuajtje të jashtëzakonshme, kërcënon edhe paqen dhe zhvillimin e shoqërisë. OKB-ja vlerëson se një në tri gra përjetojnë dhunë seksuale ose fizike gjatë jetës së tyre dhe se në kohë krize rritet kërcënimi për gratë dhe vajzat.<sup>5</sup> Më tej, një raport i kohëve të fundit nga UNODC dhe UN Women konstatoi se në mbarë botën, mesatarisht pesë gra ose vajza vriten çdo orë nga dikush në familjen e tyre.<sup>6</sup> Në Kosovë, në përputhje me trendet globale të vërejtura gjatë pandemisë, ka pasur rritje të rasteve të raportuara të dhunës në familje.<sup>7</sup> Konkretisht, ka pasur një rritje prej 20 deri në 25 për qind të raportimit nga viti 2018 në vitin 2020, në krahasim me vitet e mëparshme.<sup>8</sup> Në shumicën e rasteve, dhuna ushtrohej mbi gratë, fëmijët dhe të moshuarit. Teksa masat e karantinës kishin për qëllim parandalimin e infektiveve dhe mbrojtjen e jetëve të qytetarëve, në shumë raste kjo nënkuptonte se të mbijetuarat e dhunës në familje ishin mbyllur brenda me dhunuesit e tyre. Për pasojë, u shfaq "një pandemi brenda pandemisë", një trend që është në përputhje me të dhënat për numrin në rritje të rasteve të dhunës në familje në nivelin global. Sipas një ankete tjetër të kryer nga Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë në vitin 2019, 66 për qind e grave në Kosovë kanë qenë të mbijetuara të një forme të dhunës nga partnerët e tyre meshkuj.<sup>10</sup> Numri i rasteve të dhunës në familje të raportuara në polici është rritur në mënyrë të qëndrueshme, nga 1,541 në vitin 2018 në 1,915 në vitin 2019 dhe pak më shumë se 2,000 në vitin 2020.<sup>11</sup>

Sfidat e përmendura shpesh në adresimin e rasteve të dhunës në baza gjinore përfshijnë fajësimin e të mbijetuarave, mungesën e reagimit adekuat të policisë, normat patriarkale të ngulitura në sistemin institucional, pengesat ndaj raportimit, duke përfshirë stigmatizimin nga anëtarët e familjes dhe komunitetit, ose mungesën e garancive për raportimin e sigurt.<sup>12</sup> Më tej, një pjesë e madhe e dhunës rrjedh nga fakti se gratë në Kosovë, veçanërisht në zonat rurale, kanë më pak mundësi për ta përcaktuar në mënyrë të pavarur fatin e tyre, nga

---

4 "Dhuna në baza gjinore", UNHCR, qasur përmes <https://www.unhcr.org/gender-based-violence.html>

5 Po aty.

6 UN Women, "Njoftim për shtyp: Gratë dhe vajzat janë në risk më të madh që t'i vrasin në shtëpi, tregon raporti i ri për femicidet i UNODC dhe UN Women", qasur përmes <https://www.unwomen.org/en/news-stories/press-release/2022/11/press-release-women-and-girls-are-more-at-risk-to-be-killed-at-home-new-unodc-and-un-women-report-on-femicide-shows#:~:text=New%20York%20%E2%80%94%20new%20study,their%20own%20family%20in%202021>.

7 "Ë zënë ngushtë: sfidat e Kosovës në përballjen me pandeminë COVID-19", Avdimetal et. al., dhjetor, 2020, qasur përmes <https://qkss.org/en/publikimet/te-zene-ngushte-sfidat-e-kosoves-ne-perballjen-me-pandemine-covid-19>.

8 Intervistë me Rashit Qalaj, ish Drejtor i Policisë së Kosovës. "Të zënë ngushtë: sfidat e Kosovës në përballjen me pandeminë COVID-19", Avdimetal et. al., dhjetor, 2020, qasur përmes <https://qkss.org/en/publikimet/te-zene-ngushte-sfidat-e-kosoves-ne-perballjen-me-pandemine-covid-19>.

9 Po aty.

10 Po aty.

11 Adelina Ahmeti, "Në Kosovë, sistemi dështon në mbrojtjen e të mbijetuarave të keqtrajtimit në familje", Balkan Insight, 2021. Qasur përmes <https://balkaninsight.com/2021/04/06/in-kosovo-system-failing-to-protect-domestic-abuse-victims/>

12 Po aty.



punësimi deri te posedimi i pronës.<sup>13</sup> Pabarazia në pushtet konsiderohet si një nga faktorët kyç që ndikon në prevalencën e dhunës në baza gjinore. Siç tregon Raporti i përvitshëm i BE-së për Kosovën, sa i përket barazisë mes grave dhe burrave në punësim dhe politika sociale, diskriminimi në baza gjinore vazhdon të jetë i përhapur në rekrutim, promovim, pagë, kohëzgjatje të kontratës.<sup>14</sup> Në vitin 2020, shkalla e punësimit për popullatën 15-64 vjeç ishte 16% për gratë dhe 48.8% për burrat, duke rezultuar në një hendek shumë të lartë punësimi gjinor prej 32.8%.<sup>15</sup> Qasja e kufizuar në kujdesin për fëmijë dhe aranzhimet fleksibël të punës, si dhe rregulloret që dekurajojnë rekrutimin e grave, mbeten barriera të rëndësishme; sfida të tjera me të cilat përballen gratë, veçanërisht në zonat rurale, përfshijnë mungesën e kujdesit për të moshuarit dhe diskriminimin kur bëhet fjalë për qasjen në pronë.<sup>16</sup>

Sipas Policisë së Kosovës, deri në tetor të vitit 2022 janë raportuar 2,273 raste të dhunës në familje, ku dhuna është kryer në masë dërmuese ndaj grave ose në mbi 85 për qind të rasteve.<sup>17</sup> Megjithatë, femicidi<sup>18</sup>, që kuptohet si vrasja e një gruaje për shkak të gjinisë së saj, mbetet ndër shkeljet më ekstreme të të drejtave të njeriut si pasojë e dhunës në baza gjinore. Një nga format më të përhapura të femicidit është vrasja e grave nga një partner intim, i cili është bashkëshorti ose partneri i mëparshëm ose aktual.<sup>19</sup> Sipas një raporti të vitit 2020 nga Rrjeti i Grave të Kosovës, të paktën 74 gra janë vrarë nga partnerët ose të afërmit e tyre burra nga viti 2017 deri në vitin 2020, pra rreth një vrasje çdo tre javë.<sup>20</sup> Në shumicën e rasteve, të mbijetuarat janë sulmuar ose keqtrajtuar para vrasjes.<sup>21</sup>

Femicidi konsiderohet një fenomen që rrjedh në masë të madhe nga normalizimi i dhunës ndaj grave në shoqëritë patriarkale, ku normat kulturore priren t'i legjitimojnë ose arsyetojnë këto vrasje. Në vend që të jenë akte të izoluar të dhunës së skajshme apo një krim që kryhet prej një grupi të vogël burrash, femicidi "është pasojë e një ideologjie të trashëguar nga shekulli në shekull: e ideologjisë së mizogjinisë, pra urrejtjes së grave ose paragjyqimeve të thella ndaj tyre dhe njerëzisë së tyre."<sup>22</sup> Çka është më shqetësuese, shumica e të mbijetuarave të femicidit i kishin raportuar më parë tek autoritetet vrasësit e tyre të mundshëm.<sup>23</sup>

Dështimet e dukshme të mbrojtjes institucionale lejojnë që dhuna e raportuar në familje të rezultojë në femicid. Për shembull, në rastin e vrasjes së Marigona Osmanit, 18 vjeçares, e

13 Aleksandar Brezar, "A është vrasja brutale e Marigona Osmanit pikë kthese për shoqërinë kosovare?", Uncovering Europe, 2021. Qasur përmes <https://www.euronews.com/my-europe/2021/09/02/is-the-brutal-murder-of-marigona-osmani-a-tipping-point-for-kosovan-society>.

14 "Raporti për Kosovën 2021", Politika Evropiane e Fajnisë dhe Negociatat e Zgjerimit, Komisioni Evropian, 2021. Qasur përmes [https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/kosovo-report-2021\\_en](https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/kosovo-report-2021_en).

15 Po aty.

16 Po aty.

17 "Mbi 2.200 raste të dhunës në familje deri në tetor", Koha.net, 2022. Qasur përmes: <https://www.koha.net/arberi/357535/mbi-2-200-raste-te-dhunes-ne-familje-deri-ne-tetor/>

18 Termi u definua për herë të parë në Meksikë në vitin 2006, si: "tërësia e krimeve kundër njerëzimit që konsiston në vrasjet, rrëmbimet dhe zhdukjet e vajzave dhe grave në një kontekst kolapsi institucional. Është tregues i një sundimi të thyer ligjor që favorizon pandëshkueshmërinë. Femicidi është krim i shtetit." Për më shumë, shihni studimin e publikuar nga Heinrich Böll Stiftung përmes [https://eu.boell.org/sites/default/files/mexico\\_lima.pdf](https://eu.boell.org/sites/default/files/mexico_lima.pdf).

19 "Femicidi", Instituti Evropian për Barazi Gjinore, qasur përmes <https://eige.europa.eu/thesaurus/terms/1128>

20 <https://www.euronews.com/my-europe/2021/09/02/is-the-brutal-murder-of-marigona-osmani-a-tipping-point-for-kosovan-society>

21 Aleksandar Brezar, "A është vrasja brutale e Marigona Osmanit pikë kthese për shoqërinë kosovare?", Uncovering Europe, 2021. Qasur përmes: <https://www.euronews.com/my-europe/2021/09/02/is-the-brutal-murder-of-marigona-osmani-a-tipping-point-for-kosovan-society>.

22 Shqipe Gjocaj, "SHLYERJA E GRAVE TË VRARA TË KOSOVËS", Kosovo 2.0, 2020. Qasur përmes: <https://kosovotwopointzero.com/en/the-herasure-of-kosovos-murdered-women/>

23 Po aty.

cila dyshohet se u torturua dhe u vra nga partneri dhe bashkëpunëtori i tij, kryesit u lanë të lirë me mbi 135 akuza penale, përfshirë akuza të rënda penale si p.sh. Vrasje në tentativë.<sup>24</sup> Për më tepër, teksa në Kosovë po shënohej Dita Ndërkombëtare për Eliminimin e Dhunës ndaj Grave dhe në mbarë botën po fillonin 16 Ditët e Aktivizmit kundër Dhunës në Baza Gjinore, një grua u vra nga burri i saj në gjumë dhe një grua shtatzënë u vra në hyrje të një spitali nga bashkëshorti i saj, të cilin edhe ajo e kishte raportuar më parë për dhunë në familje.<sup>25</sup> Këto dështime të rënda institucionale në mbrojtjen e grave kanë ndezur zemërim, veçanërisht në mesin e aktivisteve feministe, të cilat bëjnë thirrje për më shumë llogaridhënie, dhënien fund pandëshkueshmërisë dhe trajtimin e dhunës ndaj grave si emergjencë kombëtare.<sup>26</sup>

---

24 Besa Luci, "Vrasja e Marigonës", Kosovo 2.0, 2022. Qasur përmes: <https://kosovotwopointzero.com/en/the-murder-of-marigona/>

25 Ardita Zeqiri, "Protesta në Prishtinë pas vrasjes së gruas shtatzënë në oborrin e spitalit", Prishtinë Insight, 2022. Qasur përmes: <https://prishtinainsight.com/protest-in-prishtina-after-pregnant-womans-murder-in-hospital-courtyard/>.

26 Po aty.

# KORNIZA LIGJORE DHE HARTËZIMI I PALËVE TË INTERESIT

---

Korniza ligjore dhe institucionale e lidhur me barazinë gjinore dhe mbrojtjen nga dhuna në baza gjinore në Kosovë konsiderohet mjaft e avancuar, dhe kryesisht në përputhje me standardet e BE-së dhe ato ndërkombëtare. Megjithatë, sfida mbetet në zbatimin e këtyre ligjeve për t'i mbrojtur të mbijetuarat, për të garantuar llogaridhënien, për t'i dhënë fund pandëshkueshmërisë dhe për t'i frenuar vepra të tjera të ngjashme në të ardhmen. Në vitin 2020, Kosova miratoi një amendament kushtetues duke i dhënë efekt të drejtpërdrejtë Konventës së Stambollit, një traktat madhor për të drejtat e njeriut që vendos standarde ligjore gjithëpërfshirëse për të garantuar të drejtën e grave për të qenë të lira nga dhuna.<sup>27</sup> Përdhunimi, sulmet seksuale dhe forma të tjera të dhunës në baza gjinore mbeten të përhapura, por nuk raportohen sa duhet.<sup>28</sup> Edhe në dritën e rasteve të raportuara, ka pasur shumë pak dënime për krime të tilla duke qenë se Kodi Penal nuk e përkufizon dhunën në familje si vepër penale, duke i trajtuar krimet e kryera vetëm brenda marrëdhënieve familjare në procedurë civile.<sup>29</sup> Megjithatë, në vitin 2019, Kodi Penal i Republikës së Kosovës u ndryshua për të lehtësuar edhe ndjekjen penale të dhunës në baza gjinore, duke i përcaktuar si vepra penale të gjitha aktet e dhunës në familje, përfshirë ngacmimin seksual dhe gjymtimin gjenital femëror.<sup>30</sup> Konkretisht, në kontekstin e dhunës seksuale, Kodi Penal përcakton termin "pëlqim" dhe disa rrethana jo shteruese ku nuk mund të thuhet se është marrë pëlqimi, duke adoptuar kështu një qasje të bazuar në kontekst për pëlqimin.<sup>31</sup>

**Ligji Nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore** e garanton dhe mbron barazinë gjinore si vlerë themelore të zhvillimit demokratik të shoqërisë.<sup>32</sup> Dhuna në baza gjinore përkufizohet në ligj si "një formë e diskriminimit e cila seriozisht pengon aftësinë e femrave dhe meshkujve që t'i gëzojnë të drejtat dhe liritë në baza të barabarta dhe është e ndaluar" bazuar në nenin 4 për ndalimin e diskriminimit gjinor.<sup>33</sup> **Ligji Nr. 03/L-182 për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje** ka për qëllim parandalimin e dhunës në familje, në të gjitha format e saj, me masa të përshtatshme ligjore, të pjesëtarëve të familjes, që janë të mbijetuara të dhunës në familje; po ashtu, ka për qëllim edhe trajtimin e kryerësve të dhunës në familje dhe lehtësimin e pasojave.<sup>34</sup> Në bazë të këtij ligji, masat mbrojtëse shqiptohen me qëllim të parandalimit të dhunës në familje, për mbrojtjen e personit që i është ekspozuar dhunës, duke mënjанuar rrethanat që ndikojnë apo mund të ndikojnë në kryerjen e veprave të tjera.<sup>35</sup> Ky ligj parasheh që "çdo gjykatë komunale është kompetente për të shqyrtuar kërkesën

---

27 "Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (Konventa e Stambollit)", Këshilli i Evropës, 2022. Qasur përmes: <https://www.coe.int/en/web/istanbul-convention/>.

28 "Kodi Penal i Kosovës kriminalizon dhunën në familje, ngacmimin seksual", Rrjeti i Grave të Kosovës, 2019. Qasur përmes: <https://womensnetwork.org/kosovo-criminal-code-criminalizes-domestic-violence-sexual-harassment/>

29 Po aty.

30 Po aty.

31 Po aty.

32 "Ligji për Barazi Gjinore", Kuvendi i Kosovës, 2015. Qasur përmes: [https://equineteurope.org/wp-content/uploads/2019/10/Annex-LAW\\_NO\\_05\\_L-020\\_ON\\_GENDER\\_EQUALITY.pdf](https://equineteurope.org/wp-content/uploads/2019/10/Annex-LAW_NO_05_L-020_ON_GENDER_EQUALITY.pdf)

33 Po aty.

34 "Ligji Nr. 03/L-182 për mbrojtje kundër dhunës në familje", Kuvendi i Republikës së Kosovës, 2010. Qasur në: <http://old.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2010-182-eng.pdf>

35 Po aty.

për urdhër mbrojtje ose urdhër mbrojtje emergjente dhe për të shqiptuar urdhrin.<sup>36</sup> **Ligji Nr. 2004/32 për Familjen i Kosovës**<sup>37</sup> rregullon fejesën, martesën, marrëdhëniet ndërmjet prindërve dhe fëmijëve, birësimin, kujdestarinë, mbrojtjen e fëmijëve pa përkujdesje prindërore, marrëdhëniet pasurore familjare dhe procedurat e posaçme gjyqësore për kontestet e marrëdhënieve familjare. Ky ligj përqendrohet në pajtimin, i cili në kontekstin e dhunës në baza gjinore paraqet një shqetësim të madh pasi jep pak udhëzime se si të kontrollohen dhe trajtohen rastet që përfshijnë një historik të dhunës në familje.<sup>38</sup>

Gjithashtu, në janar 2022 u miratua **Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave (2022–2026)** me fushëveprim më të gjerë se variantet e saj të mëparshme, duke u fokusuar në dhunën në familje dhe duke i përcaktuar objektivat e saj në kontekstin e zbatimit të masave të ndjeshme gjinore në përputhje me Konventën e Stambollit.<sup>39</sup>

Institucionet kryesore që janë të mandatuara për të parandaluar dhunën në baza gjinore dhe për të ofruar shërbime për të mbijetuarat në Kosovë, përfshijnë Policinë e Kosovës, Prokuroritë, Gjykatat, Koordinatorin e Kosovës për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje/ Zëvendës Ministri i Ministrisë së Drejtësisë, Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Qendrat për Punë Sociale, Zyrën për Mbrojtjen e Viktimave/Mbrojtësit e Viktimave, Linjën e Ndhmës, Ofruesit e Kujdesit Shëndetësor, Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë / Drejtoritë e Arsimit, Shkollat, Avokatin e Popullit/departamenti për barazi gjinore, Strehimoret dhe Shoqërinë Civile.<sup>40</sup> Adresa e parë për të mbijetuarat e dhunës në baza gjinore është zakonisht Policia e Kosovës (PK) ku raportohen rastet e DHBGJ-së. Më pas, policia i referon rastet në Qendrat për Punë Sociale ose strehimoret për të mbijetuarat të dhunës në familje, për mbështetje dhe ndihmë financiare të mëtejshme. Zyra për Mbrojtjen e Të mbijetuarave i ndihmon dhe përfaqëson të mbijetuarat e dhunës në familje dhe krime të tjera gjatë procedurave të tyre në polici, prokurori ose në gjykatë.<sup>41</sup>

---

36 Po aty.

37 Për amandamentimin e tij shih Ligjin Nr. 06/L-077 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Familjen të Kosovës.

38 Po aty.

39 "Strategjia Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave 2022– 2026", Ministria e Drejtësisë, Qeveria e Kosovës, 2022. Qasur përmes: <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/08/ENG-Strategjia-Kombetare-per-Mbrojtje-nga-Dhuna-ne-Familje-dhe-Dhuna-ndaj-Grave-2022-2026.pdf>

40 "Raportimi për Dhunën në Familje: Udhëzime për Gazetarët", OSBE, 2018. Qasur përmes: [osce.org/files/f/documents/9/2/404348.pdf](https://osce.org/files/f/documents/9/2/404348.pdf)

41 Diskutim në grupin e fokusit në Kamenicë, 25 maj 2022. Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë.

# METODOLOGJIA

---

Qëllimi i këtij raporti është të ofrojë një vlerësim bazë të dhunës në baza gjinore (DHBGJ) në Kosovë, me fokus në këndvështrimet e komunitetit dhe të palëve të interesit. Konkretisht, përmbajtja e këtij raporti u siguroa përmes hulumtimit, diskutimeve në grupe të fokusit, intervistave me palët e interesit, si dhe të dhënave të anketimit të mbledhura përmes instrumentit të Barometrit të Sigurisë në Ballkanin Perëndimor (BSBP). Fillimisht, u krye shqyrtimi i literaturës për ta ndërtuar kontekstin dhe për ta kthjelluar të kuptuarit e koncepteve kyçe që lidhen me dhunën në baza gjinore, duke përfshirë një pasqyrë të kornizës legjislative dhe strategjike, si dhe të dokumenteve të politikave dhe komenteve të mediave që shqyrtojnë qasjen e Kosovës në parandalimin dhe adresimin e dhunës në baza gjinore.

Së dyti, me qëllim të eksplorimit të perceptimeve të komuniteteve për dhunën në baza gjinore, u organizuan 14 diskutime në grupe të fokusit nëpër komuna të ndryshme në Kosovë. Përfaqësues të ndryshëm të komuniteteve u ftuan të jenë pjesë e diskutimeve në grupe të fokusit, duke përfshirë përfaqësues nga Policia e Kosovës, strukturat e qeverisjes lokale si punëtorët komunalë, aktivistët e të drejtave të njeriut, punëtorët socialë, gjyqtarët, mbrojtësit e të mbijetuarave, psikologët, liderët e komunitetit, dhe punëtorë të tjerë të vijës së parë etj. Qëllimi i diskutimeve në grupe të fokusit ka qenë të kuptohet më mirë prevalenca e dhunës në baza gjinore, të identifikohen qëndrimet e komunitetit ndaj kësaj çështje, si dhe sfidat në qasjen institucionale, duke zbuluar potencialisht trendet e mundshme nga komunat. Gjegjësisht, diskutime në grupe të fokusit u organizuan në komunat e Istogut, Drenasit, Fushë Kosovës, Kamenicës, Klinës, Klllokotit, Vushtrrisë, Lipjanit, Gjakovës, Gjilanit, Mitrovicës, Podujevës, Suharekës dhe Vitisë.

Së treti, marrë parasysh rolin e rëndësishëm të Qendrave për Punë Sociale (QPS) në ofrimin e shërbimeve kritike për të mbijetuarat e dhunës në familje, janë realizuar nëntë intervista me informues kyç (IIK) me përfaqësues të shtatë strehimoreve për të mbijetuarat e dhunës në familje në Kosovë. Konkretisht, janë realizuar intervista të thelluara me përfaqësues nga strehimoret për të mbijetuarat e dhunës në familje në komunat e Ferizajt, Gjakovës, Gjilanit, Mitrovicës, Pejës, Prishtinës dhe Prizrenit. Së katërti, mbledhja e të dhënave cilësore për këtë studim u plotësua me të dhëna sasiore të marra nga Barometri i Sigurisë në Ballkanin Perëndimor (BSBP), një instrument i posaçëm përmes të cilit Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) mat perceptimet e publikut në nivel rajonal për të matur besimin e publikut në institucione, perceptimet ndaj kërcënimeve dhe risqeve, dhe çështjet prioritare që duhet të adresohen. Ky studim është i kufizuar në fushëveprim sa i përket ofrimin të një pasqyre më gjithëpërfshirëse të dhunës në baza gjinore në Kosovë, përfshirë krahasimet në nivel mikro ndërmjet komunave. Megjithatë, ai ofron njohuri të vlefshme që tregojnë për përhapjen e dhunës në baza gjinore nëpër komunat e Kosovës, hendekët e mëdhenj në ofrimin e shërbimeve për të mbijetuarat, si dhe neglizhencën institucionale dhe trajtimin e papërshtatshëm të rasteve recidiviste që kanë çuar në femicid. Bazuar në diskutimet në grupe të fokusit, intervistat me informues kyç, si dhe anketën e BSBP-së, ky studim paraqet disa nga gjetjet kryesore në paragrafët e mëposhtëm.

# GJETJET KYÇE



## Të dhënat dhe trendet e raportimit për dhunën në baza gjinore

**Rastet e raportuara të dhunës në baza gjinore paraqesin një trend në rritje në të gjitha komunat** – Të dhënat tregojnë se në të gjitha komunat janë rritur rastet e raportuara të dhunës në baza gjinore, edhe pse me ritme të ndryshme dhe manifestohen përmes një sërë krimesh të dhunës në baza gjinore, përfshirë dhunë psikologjike dhe seksuale. Një nga komunat me rritjen më të madhe të rasteve të raportuara të dhunës në baza gjinore ka qenë komuna e Mitrovicës. Përfaqësuesit institucionalë kanë vërejtur gjatë diskutimit në grup të fokusit se ka pasur një rritje prej 34% të rasteve të raportuara të dhunës në familje në Mitrovicë gjatë viteve 2021-2022, krahasuar me periudhën 2019-2020.<sup>42</sup> Ky trend në rritje konsiderohet se ka filluar në mars 2020. Për shembull, teksa në vitin 2021 ishin strehuar 15 persona si të mbijetuara të dhunës në familje, në tremujorin e parë të këtij viti janë strehuar 55 persona.<sup>43</sup> Strehimorja për të mbijetuarat e dhunës në familje në Mitrovicë e ka tejkaluar kapacitetin e saj maksimal, duke u detyruar të shfrytëzojë shtretërit që ishin në dispozicion për raste emergjente.<sup>44</sup> Komuna e Gjakovës ka shënuar një rritje prej 12 për qind të rasteve të raportuara të dhunës në familje, çka pjesëmarrësit në grup të fokusit e konsiderojnë më shumë si shenjë të rritjes së vetëdijes sesa rritje të dhunës aktuale.<sup>45</sup> Kjo e bën Gjakovën komunën e dytë me shkallën më të lartë të dhunës në familje pas Prishtinës.<sup>46</sup> Gjithsej, për vitin 2021 ka pasur 157 raste, ku 87 të mbijetuara kanë kërkuar ndihmë mjekësore, shumica e të cilëve janë gra.<sup>47</sup> Strehimorja për të mbijetuarat e dhunës në familje në Gjakovë gjithashtu ka arritur kapacitetin e plotë, duke e detyruar stafin që t'i zvogëlojë hapësirat e përbashkëta duke i kthyer në hapësira private për strehimin e të mbijetuarave.<sup>48</sup>

**Edhe kërkesat për urdhra të mbrojtjes të shqiptuar nga gjykata janë rritur gjatë vitit të shkuar** – Krahas rritjes së rasteve të raportuara të dhunës në familje, është raportuar edhe rritje e kërkesave për urdhër të mbrojtjes të shqiptuar nga gjykata. Për shembull, në komunën e Gjilanit, në vitin 2021 ka pasur 180 raste të dhunës në baza gjinore, pesë prej të cilëve kanë përfshirë pjesëtarë të komuniteteve etnike jo-shumicë në Kosovë.<sup>49</sup> Siç vuri në dukje një pjesëmarrës në grupin e fokusit, ka pasur 88 kërkesa për urdhra të mbrojtjes të shqiptuar nga gjykata dhe “këtë vit të mbijetuarat po kërkojnë më shumë urdhra të mbrojtjes sepse ndihen në rrezik më të madh”.<sup>50</sup> Mund të argumentohet se kjo rritje e kërkesave për urdhra të mbrojtjes ka të bëjë me raportimin më të madh mediatik të rasteve të dhunës në baza gjinore, veçanërisht të rasteve të femicidit që i kanë detyruar qindra qytetarë dhe

42 Diskutim në grupin e fokusit në Mitrovicë, 19 prill 2022. Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë.

43 Po aty.

44 Intervistë me përfaqësues të Strehimores për të mbijetuarat të dhunës në familje në Mitrovicë, Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë Qershor 2022.

45 Diskutim në grupin e fokusit në Gjakovë, 1 prill 2022. Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë.

46 Po aty.

47 Po aty.

48 Intervistë me përfaqësues të Strehimores për të mbijetuarat të dhunës në familje në Gjakovë, Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë, qershor 2022.

49 Diskutim në grupin e fokusit në Gjilan, 13 maj 2022. Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë.

50 Diskutim në grupin e fokusit në Mitrovicë, 19 prill 2022. Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë

aktivistë të protestojnë në rrugë duke kërkuar mbrojtje më të madhe për të mbijetuarat e mundshme dhe përgjegjësi për kryesit e krimeve.

### **Modelet e raportimit të dhunës në familje ndryshojnë sipas moshës dhe rajonit –**

Bazuar në intervistat dhe diskutimet në grupe të fokusit, gratë më të reja kanë më shumë gjasa ta raportojnë dhunën në krahasim me gratë e grupmoshave më të mëdha. Duhet theksuar se në shumë komuna, pjesëmarrësit në grupe të fokusit kanë theksuar se të mbijetuara të dhunës në familje përfshijnë edhe të moshuarit.<sup>51</sup> Për shëmbull, në komunën e Klllokotit u theksua se “shumica e rasteve të dhunës në familje përfshijnë çifte që janë mbi 60 vjeç”. Lidhur me këtë, siç thekson një përfaqësuese e strehimores për të mbijetuara të dhunës në familje në Ferizaj, “shumica e grave që vijnë në strehimore kanë përjetuar dhunë për një kohë të gjatë, por asnjëherë nuk e kanë raportuar rastin, por pastaj kemi edhe rastet e grave të reja që janë më të vetëdijshme dhe e raportojnë më shpejt përjetimin e dhunës.”<sup>52</sup> Një pjesëmarrëse në grupin e fokusit në Mitrovicë shprehet se “ka raste kur të mbijetuarat na thonë se janë përballur me dhunën në familje që kur janë martuar, pra 20 vjet më parë.”<sup>53</sup> Në komunën e Gjakovës, shumica e të mbijetuarave në strehimoren për të mbijetuara të dhunës në familje janë të moshës 30-40 deri në 50 vjeç.<sup>54</sup> Më tej, në shumicën e komunave, shumica e rasteve të dhunës në familje vijnë nga zona të thella apo rurale.<sup>55</sup> Megjithatë, ka raste si Komuna e Mitrovicës ku “pak më shumë se 50 për qind e të mbijetuarave në strehimoren për të mbijetuara të dhunës në familje janë nga zonat urbane.”<sup>56</sup> Trende të dallueshme vërehen edhe kur bëhet fjalë për kryesin e dhunës. Marrë parasysh se në Kosovë, shumica ende jetojnë në familje me shumë gjenerata, “dhuna e ushtruar nga vjehri ose kunati është shumë e zakonshme.”<sup>57</sup>

### **Barrierat në raportimin e rasteve të DHBGJ-së përfshijnë informacionin e kufizuar të të mbijetuarave për të drejtat e tyre dhe disponueshmërinë e shërbimeve mbështetëse, stigmën sociale, mungesën e besimit në institucionet shtetërore dhe kërcënimet nga dhunuesit. –**

Një element kritik në përcaktimin e modeleve të raportimit priret të jetë niveli i vetëdijesimit të të mbijetuarave për të drejtat e tyre dhe disponueshmëria e shërbimeve mbështetëse. Siç thekson një pjesëmarrëse në grupin e fokusit në Ferizaj, “disa gra janë shprehur se nëse do ta kishim ditur për ekzistencën e kësaj strehimoreje do të kishim kërkuar ndihmë shumë më herët”. Informacioni i kufizuar shtrihet edhe në masa të tilla si urdhrat e mbrojtjes të shqiptuar nga gjykata, të cilat strehimoret duhet t’ua shpjegojnë të mbijetuarave.<sup>58</sup> Duhet të theksohet se në shumicën e komunave, pjesëmarrësit në grupe të fokusit kanë përmendur fushata të ndryshme për vetëdijesim që synojnë informimin më të mirë të publikut rreth DHBGJ-së si dhe shërbimeve të disponueshme, megjithatë, nuk ka studime të disponueshme që vlerësojnë ndikimin e saktë të përpjekjeve të tilla

---

51 Diskutim në grupin e fokusit në Vushtri, 25 tetor 2022. Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë.

52 Intervistë me përfaqësues të Strehimores për të mbijetuara të dhunës në familje në Ferizaj, 7 qershor 2022. Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë.

53 Diskutim në grupin e fokusit në Mitrovicë, 19 prill 2022. Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë.

54 Intervistë me përfaqësues të Strehimores për të mbijetuara të dhunës në familje në Gjakovë, Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë, qershor 2022.

55 Intervistë me përfaqësues të Strehimores për të mbijetuara të dhunës në familje në Gjakovë, Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë, qershor 2022.

56 Intervistë me përfaqësues të Strehimores për të mbijetuara të dhunës në familje në Gjakovë, Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë, qershor 2022.

57 Intervistë me përfaqësues të Strehimores për të mbijetuara të dhunës në familje në Prishtinë, Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë. Maj 2022.

58 Intervistë me përfaqësues të Strehimores për të mbijetuara të dhunës në familje në Prishtinë, Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë. Maj 2022.



për vetëdijesim, përfshirë trendet e raportimit të DHBGJ-së.<sup>59 60</sup> Më tej, gjatë raportimit të rasteve të dhunës në familje në rrethin e saj shoqëror, një pjesëmarrëse në grupin e fokusit në Mitrovicë vëren "Jam përballur me kërcënime nga dhunuesit dhe jam paragjykuar nga familja dhe miqtë e të mbijetuarës për ngritjen e zërit kundër këtij fenomeni."<sup>61</sup> Një pjesëmarrës tjetër në grup të fokusit vëren se "shumë shpesh të mbijetuarat na thonë mos vini të na merrni në shtëpitë tona; ne do t'ju telefonojmë drejtpërdrejt."<sup>62</sup> Në shumë raste, gratë hezitojnë t'i raportojnë rastet e dhunës në baza gjinore derisa të shohin një kërcënim të menjëhershëm për jetën e tyre.<sup>63</sup>

Një pjesëmarrëse në grupin e fokusit në Klinë thekson se "kur një grua vendosë ta raportojë një rast, duhet pasur parasysh se ka gjasa të bëhet fjalë për një rast recidivist, sepse rrallë herë dhuna raportohet menjëherë; zakonisht do të thotë që gratë kanë vuajtur për mjaft kohë deri sa marrin vendimin për ta raportuar dhunën në polici."<sup>64</sup> Më pas, shumë të mbijetuara të DHBGJ-së dekurajohen nga policia, pasi "ka pasur raste kur policia e ka normalizuar dhunën duke thënë deklarata të tipit 'nuk është fundi i botës që të ka goditur me shuplakë.'<sup>65</sup> Më tej, rastet e recidivistëve që janë raportuar prej vitesh rezultojnë në femicid – çka e dekurajon më tej raportimin e DHBGJ-së – "ato [të mbijetuarat] e shohin se shteti i ka braktisur dhe nuk duan më të raportojnë."<sup>66</sup> Në komunitetet e vogla, me qasje të kufizuar në transportin publik, gratë përballen me barriera për t'i shpëtuar dhunës dhe ato varen nga disa aspekte.<sup>67</sup> Në shumë raste, atyre u mungon informacioni i nevojshëm për të kërkuar ndihmë, përballen me paragjykime dhe shumica e tyre janë të papuna, dhe në rastet kur e raportojnë dhunë, gjasa janë do t'i shikojnë shtrembër dhe do të etiketohen si "ato që shkuan në polici."<sup>68</sup>

**Besimi në institucionet e sigurisë dhe drejtësisë është një faktor kyç që ndikon në raportimin e DHBGJ-së nga të mbijetuarat** – Një nga sfidat kyçe të identifikuara për sa i përket trendeve të raportimit të DHBGJ-së përfshin rolin e rëndësishëm të besimit që të mbijetuarat kanë në institucione. Konsiderohet se "mungesa e besimit në institucione, e shoqëruar me turpin dhe frikën nga raportimi, i bën gratë të hezitojnë t'i raportojnë rastet e DHBGJ-së, që do të thotë se dhuna raportohet vetëm kur ajo përshkallëzohet – duke e bërë më të vështirë trajtimin e saj në fazat shumë të hershme."<sup>69</sup> Për shembull, në strehimoren për të mbijetuarat e dhunës në familje në Gjilan "ka pasur raste kur në momentin që e mbijetuara e ka marrë vesh se do të përfshihet policia dhe prokuroria, ajo ka ikur nga strehimorja.<sup>70</sup> Duhet të merret seriozisht niveli i lartë i mosbesimit dhe madje edhe i frikës së të mbijetuarave nga përfshirja e institucioneve të sigurisë, pasi që të mbijetuarat mbeten të pashpresa kur ata që janë të mandatuar për t'i mbrojtur ato shihen me dyshim

59 Diskutim në grupin e fokusit në Podujevë, 27 prill 2022. Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë.

60 Intervistë me përfaqësues të Strehimores për të mbijetuara të dhunës në familje në Ferizaj, 7 qershor 2022. Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë.

61 Diskutim në grupin e fokusit në Mitrovicë, 19 prill 2022. Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë.

62 Po aty.

63 Diskutim në grupin e fokusit në Gjilan, 13 maj 2022. Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë.

64 Diskutim në grupin e fokusit në Klinë, 18 tetor 2022. Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë.

65 Diskutim në grupin e fokusit në Fushë Kosovë, 14 tetor 2022. Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë.

66 Po aty.

67 Po aty.

68 Po aty.

69 Diskutim në grupin e fokusit në Klinë, 18 tetor 2022. Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë.

70 Intervistë me përfaqësues të Strehimores për të mbijetuara të dhunës në familje në Gjilan, Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë, qershor 2022.

Shpesh, kur gratë kanë frikë nga policia, ato i raportojnë rastet e tyre të DHBGJ-së drejtpërdrejt në QPS.<sup>71</sup> "Raportimi i DHBGJ-së bëhet edhe më sfidues në kontekstin e komunave të vogla ku pothuajse të gjithë e njohin njëri-tjetrin.<sup>72</sup> Më tej, pandëshkueshmëria, shkalla shumë e ulët e dënimeve të kryesve të DHBGJ-së dhe procedurat e tejzgjatura ligjore, i bëjnë gratë të hezitojnë të raportojnë DHBGJ-në edhe pse nuk kanë ku të shkojnë tjetër.<sup>73</sup> Pra, është një dukuri e zakonshme që gratë t'i tërheqin akuzat e tyre ndaj bashkëshortit me qëllim që t'u ofrojnë atyre një mundësi tjetër për pajtim.<sup>74</sup>

### **Normat tradicionale dhe përpjekjet për ndërmjetësim familjar ndërmjet dhunuesve dhe të mbijetuarave të dhunës në familje e ndërlikojnë më tej raportimin për DHBGJ dhe reagimin vijues institucional**

Koordinimi ndërinstitutional është i domosdoshëm për të siguruar që rastet e dhunës në baza gjinore, përfshirë rastet e dhunës në familje, të adresohen në mënyrë adekuate përmes një qasje me të mbijetuarën në qendër. Megjithatë, në kontekstin e normave patriarkale të rrënjësura shoqërore, veçanërisht në zonat më rurale dhe të thella të Kosovës, ku incidenca e dhunës në familje është e përhapur dhe shpesh e nën-raportuar – normat tradicionale e komplikojnë më tej reagimin institucional. Në raste të tilla, dhe shpesh duke marrë parasysh pajtimin ndërmjet të mbijetuarës dhe dhunuesit, për t'i adresuar rastet e dhunës në familje palët e prekura i anashkalojnë institucionet, siç është Policia e Kosovës, duke i ndërmjetësuar këto raste përmes mbledhjes në 'oda'.<sup>75</sup> Kjo i lë rastet e shumta të DHBGJ-së të paraportuara dhe të mbijetuarat me pak mbrojtje ose qasje në mbështetje. Këto raste mund të përshkallëzohen shpejt në fatalitete, siç ilustrohet nga një rast i dhunës në familje, i cili përfshinte një kryes recidivist në Mitrovicë. Gruaja e raportoi burrin e saj në polici me rezerva që nuk ia lejua ta ndante të gjithë përvojën e saj. Më tej, ka pasur përpjekje nga familjet për ta pajtuar gruan me burrin e saj dhunues, dhe megjithëse dy familjet e përfshira thuhet se ishin 'pajtuar' të mos ushtronin dhunë, si përfundim burri e vrau gruan e tij.<sup>76</sup> Ky rast ilustron më tej se anashkalimi i institucioneve dhe zgjedhja që çështja të trajtohet përmes odave e bën çështje thelbësore qasjen e të mbijetuarave të dhunës në familje në shërbime që mund të shpëtojnë jetë.<sup>77</sup>

### **Shkeljet e parimeve të konfidencialitetit ndikojnë negativisht në nivelet e raportimit të rasteve të dhunës në familje**

Kjo çështje është ngritur në disa raste gjatë intervistave tona dhe diskutimeve në grupe të fokusit. Siç vë në dukje një pjesëmarrëse në grupin e fokusit në Drenas, "një nga shqetësimet kryesore për të mbijetuarat është kur subjektet si mediat rregullisht shkelin parimin e konfidencialitetit, duke shkelur drejtpërdrejt integritetin e të mbijetuarës.<sup>78</sup> Një pjesëmarrëse në grupin e fokusit në komunën e Kamenicës thotë se "Kemi pasur një rast të dy vajzave të cilat me rekomandimin e nënës së tyre kanë kërkuar që të dërgohen në strehimore familjare. Megjithatë, ne jemi përballur me një sfidë të madhe, sepse ende pa mbërritur në familje, lajmi kishte dalë dhe më pas të mbijetuarat e dhunës në familje janë përballur me probleme."<sup>79</sup> Mbrojtja e konfidencialitetit të të mbijetuarave është një problem i madh pasi ka pasur raste që brenda 24 orëve të raportimit, rasti publikohet

---

71 Po aty.

72 Po aty.

73 Diskutim në grupin e fokusit në Klinë, 18 tetor 2022. Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë.

74 Diskutim në grupin e fokusit në Suharekë, 2 mars 2022. Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë.

75 Diskutim në grupin e fokusit në Podujevë, 27 prill 2022. Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë.

76 Diskutim në grupin e fokusit në Mitrovicë, 19 prill 2022. Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë.

77 Po aty.

78 Diskutim në grupin e fokusit në Drenas, 16 shtator 2022. Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë.

79 Diskutim në grupin e fokusit në Kamenicë, 25 maj 2022. Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë

në platformat online si dhe lajmet kryesore në qytet”, shtojnë ata.<sup>80</sup> Për më tepër, “pas publikimit të lajmit, kjo e bën publikun edhe më kurioz, duke çuar në hetimin e mëtejshëm mediatik të rastit, duke shkelur shpesh të drejtën e të mbijetuarës për privatësi – prandaj është e rëndësishme që media të ndjekë rregullorë të rrepta për raportimin e rasteve të DHBGJ-së”.<sup>81</sup>

**Burokracia dhe procedurat e gjata ligjore e dekurajojnë më tej raportimin e DHBGJ-së** – Është raportuar se mekanizmave vendorë u mungojnë kompetencat për trajtimin e DHBGJ-së dhe se përpjekjet për decentralizimin nuk janë funksionalizuar plotësisht. Komunitat kanë buxhete të kufizuara dhe atyre u mungon një vijë e veçantë buxhetore për të mbijetuarat e DHBGJ-së. Shpesh herë, procesi i raportimit të një rasti të DHBGJ-së është aq burokratik sa që disa të mbijetuara zgjedhin të heqin dorë në gjysmë të rrugës pasi iu duket tepër i rëndë.<sup>82</sup> Për shembull, një pjesëmarrëse në grupin e fokusit në Klinë vëren se, “burokracia e gjatë, e cila kërkon që një grua të merret me 10 zyra për ta raportuar DHBGJ-në, është shumë dekurajuese, dhe pastaj është çështja kur të dhënat transferohen nga një zyrë në tjetrën që e bën çështjen edhe më e vështirë për t’u trajtuar.”<sup>83</sup>

**QPS-të i japin prioritet pajtimit ndërmjet të mbijetuarës dhe kryesit të dhunës në familje, duke mos arritur të ofrojnë garanci të sigurisë për të mbijetuarën dhe duke rritur riskun e sjelljes recidiviste nga dhunuesi.** Siç thekson një përfaqësues nga QPS-ja në komunën e Kamenicës, “Ne ofrojmë këshilla për rregullimin e marrëdhënieve familjare. Ne përpiqemi t’i pajtojmë çiftet që të mos kemi probleme sociale me fëmijët e tyre.”<sup>84</sup> Ai shton se “QPS-të përpiqen të ndërmjetësojnë mes çifteve në mënyrë që ata të pajtohen dhe që fëmijët të rriten në familje”, megjithatë nuk e shtjellon se cilat janë pasojat për fëmijët kur rriten në mjedise të karakterizuara nga dhuna dhe jo të favorshme për zhvillimin e shëndetshëm të fëmijës. Pjesëmarrësit në grupe të fokusit shpjegojnë se fokusimi në pajtimin e familjarëve në rastet e dhunës në familje ka filluar të ndiqet si procedurë, megjithëse nuk është e zbatueshme për të gjitha rastet. Siç thonë, “në bazë të deklaratave që marrim, gjykojmë nëse ka hapësirë për pajtim, edhe pse ka pasur raste kur kjo qasje ka qenë e suksesshme si dhe kur ka përfunduar me dhunë”, d.m.th. e pranojnë se “është një procedurë problematike – prandaj nuk insistojmë.”<sup>85</sup>

**Institucionet nuk po arrijnë t’i trajtojnë dhe parandalojnë në mënyrë efektive rastet e dhunës në baza gjinore** – Bazuar në të dhënat e mbledhura, ka pakënaqësi të gjerë me punën e institucioneve kryesore të përfshira në trajtimin dhe parandalimin e DHBGJ-së, me fokus të veçantë në punën e gjyqësorit dhe prokurorisë. Një pjesëmarrëse në grupin e fokusit në Viti thekson se “Jo, nuk jemi të kënaqur me punën e gjyqësorit apo prokurorisë, sepse në gjykatë zëri ynë nuk dëgjohet – gjithë punë është e ka të njoftshëm. Jemi dekurajuar shumë kur kemi parë gjykatën t’i nënvlerësojë rastet e dhunës në familje.”<sup>86</sup>

80 Po aty.

81 Po aty.

82 Diskutim në grupin e fokusit në Vushtrri, 25 tetor 2022. Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë.

83 Diskutim në grupin e fokusit në Klinë, 18 tetor 2022. Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë.

84 Diskutim në grupin e fokusit në Kamenicë, 25 maj 2022. Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë.

85 Po aty.

86 Diskutim në grupin e fokusit në Viti, 4 mars 2022. Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë.

## Procesi i trajtimit të rasteve të dhunës në baza gjinore: sfidat dhe kufizimet

---

**Policia e Kosovës, Qendrat për Punë Sociale (QPS) dhe Strehimoret për të mbijetuarat e Dhunës në Familje janë institucionet kyçe për adresimin e rasteve të DHBGJ-së, dhe koordinimi me tyre është me rëndësi kritike.** – Trekëndëshi i institucioneve për trajtimin e rasteve të dhunës në baza gjinore përfshin Policinë e Kosovës, Qendrat për Punë Sociale dhe Strehimoret për të mbijetuarat e Dhunës në Familje. Roli i QPS-së është veçanërisht i rëndësishëm në rastet kur përfshihen fëmijët. Siç shpjegon përfaqësuesi i strehimores për të mbijetuarat e dhunës në familje në Ferizaj, “ndonjëherë e mbijetuara e dhunës në familje nuk e raporton rastin në polici por në Qendrën për Punë Sociale, prandaj ato raste na i referojnë neve.”<sup>87</sup> Ndonëse bashkëpunimi mes këtyre institucioneve konsiderohet përgjithësisht i mirë, ka raste kur “e mbijetuara e raporton rastin e saj në polici, por policia nuk e referon rastin e saj në strehimore.”<sup>88</sup> Për më tepër, “ka raste që ‘vetë-referohen’, zakonisht për shkak se nuk guxojnë ta raportojnë rastin e tyre në polici sepse kanë njohje personale me policinë ose zyrtarët në QPS dhe kanë frikë – megjithatë, ne nuk mund t’i lëmë pa raportuar, sepse ligji na e ndalon këtë.”<sup>89</sup>

**Të mbijetuarat janë në risk edhe nga mangësitë në zbatimin e Procedurave Standarde të Veprimit (PSV) për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje** – PSV-të përcaktojnë veprimet specifike që duhen ndërmarrë nga profesionistët për identifikimin dhe raportimin e dhunës në familje, vlerësimin e riskut dhe referimin e të mbijetuarave në shërbimet mbështetëse, mbrojtjen dhe rimëkëmbjen e të mbijetuarave si dhe trajtimin e kryesve të dhunës në familje.<sup>90</sup> Për shembull, siç vë në dukje përfaqësuesi i strehimores për të mbijetuarat e dhunës në familje në Mitrovicë, “Shpesh hasim probleme sepse dhunuesit vijnë në strehimore, edhe pse policia reagon shpejt dhe i arreston.”<sup>91</sup> Në një rast tjetër, një përfaqësuese e Strehimores për të mbijetuarat e dhunës në familje në Mitrovicë, ankohet se “Kemi pasur një rast ku Qendra për Punë Sociale e Komunës së Shtërpcës, ka dërguar një burrë, vjehrrin e një të mbijetuarë, duke i thënë se ai mund të shkojë ta marrë nusen e tij tek strehimorja jonë- do të thotë, një zyrtarë ka zbuluar lokacionin e strehimores” duke vënë në rrezik direkt të mbijetuarën.<sup>92</sup> Ngjashëm, strehimorja për të mbijetuarat e dhunës në familje në Pejë është përballur me sfida në sigurimin e lokacionit të strehimores pasi “kemi pasur raste kur policia e ka bërë të ditur lokacionin e strehimores.”<sup>93</sup> Më tej, një përfaqësues nga zyra e Avokatit të Popullit vëren se, “ne bëjmë raporte për dështime në mbrojtjen e të drejtave të njeriut, të cilët mund të shërbejnë si masa parandaluese për të ardhmen,

---

87 Intervistë me përfaqësues të Strehimores për të mbijetuara të dhunës në familje në Ferizaj, 7 qershor 2022. Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë.

88 Po aty.

89 Po aty.

90 Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (Konventa e Stambollit), Këshilli i Evropës, 2022. Qasur përmes: <https://www.coe.int/en/web/istanbul-convention/>.

91 Intervistë me përfaqësues të Strehimores për të mbijetuara të dhunës në familje në Mitrovicë, Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë, qershor 2022.

92 Po aty.

93 Intervistë me përfaqësues të Strehimores për të mbijetuara të dhunës në familje në Pejë, qershor 2022. Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë.

megjithatë, roli i mekanizmave koordinues do të jetë i kotë nëse nuk zbatohen PSV-të.<sup>94</sup> Në disa raste, përfaqësuesit e policisë pjesëmarrës në grupe të fokusit nuk ishin të sigurt për të gjitha hapat e përfshirë në procesin e dërgimit të të mbijetuarës në strehimoren për të mbijetuarat e dhunës në familje.<sup>95</sup>

**Reagimi institucional konsiderohet shumë i ngadaltë dhe jo adekuat, madje i shtynë të mbijetuarat e dhunës në familje të kthehen te kryesit** – Procesi i trajtimit të një rasti të DHBGJ-së mund të jetë i ngadaltë, i gjatë dhe jo efikas. Në disa raste, kur të mbijetuarat duhet të përballen me procese ligjore për shkurorëzim ose kujdestarinë e fëmijëve, qëndrimi i të mbijetuarave në strehimore zgjatet.<sup>96</sup> Nganjëherë, vonesat në lidhje me këtë proces i shtynë të mbijetuarat të kthehen në burimin e keqtrajtimit, ndërkohë që nuk i shihet fundi adresimit të situatës së tyre.<sup>97</sup> Një përfaqësues i OJQ-së në Drenas, u shpreh se<sup>98</sup> dhuna ndaj grave paraqet një sfidë të madhe dhe është thellësisht shqetësuese që kemi reagim të ngadaltë institucional për këto raste, duke i lënë të mbijetuarat të pashpresa.<sup>99</sup> Për më tepër, ai shton se “reagimi ndaj rasteve të dhunës në baza gjinore duhet të jetë i shpejtë dhe çështja duhet të trajtohet nga shkaqet rrënjësore dhe jo vetëm nga manifestimi i saj simptomatik.”<sup>100</sup>

**Mungesa e financimit të qëndrueshëm dhe procedurat burokratike kërcënojnë mbijetesën dhe funksionalitetin e strehimoreve për të mbijetuarat e dhunës në familje** – Një konstatim konsistent gjatë intervistave me përfaqësues nga strehimoret për të mbijetuarat e dhunës në familje, është paqëndrueshmëria e tyre financiare. Siç thotë një përfaqësues i strehimores në Mitrovicë, “Nuk e dimë nëse jemi institucion shtetëror apo OJQ, sepse në fillim të çdo viti mbesim pa fonde deri sa të ndahen... po përballemi me probleme siç janë vështirësitë në kontraktimin e sigurimit, pasi që as policia nuk është në gjendje të garantojë mbrojtje. Kemi bërë kërkesë edhe nga komuna për një linjë SOS por na kanë thënë se është shumë e kushtueshme.”<sup>101</sup> Një përfaqësues tjetër i strehimores për të mbijetuarat e dhunës në familje në Ferizaj thekson se, “zakonisht në tre muajt e parë të vitit nuk kemi financim. Dikur ka pasur një fond emergjence por këtë vit nuk morëm mbështetje nga qeveria.”<sup>102</sup> Ata shtojnë se, “shpresojmë që të krijohet një vijë e veçantë buxhetore për strehimoret; është e dhimbshme të shohim një grua dhe fëmijën e saj që vijnë tek ne dhe ne nuk mund t’u ofrojmë atyre as shërbimet më elementare.”<sup>103</sup> Një përfaqësues i strehimores për të mbijetuarat e dhunës në familje në Gjakovë thekson se financimi nga donatorët ndërkombëtarë nuk i plotëson të gjitha nevojat që ata kanë, sepse ato mjete buxhetohen kryesisht për projekte si ngritja e vetëdijesimit, por jo për ofrimin e shërbimeve emergjente si akomodimi, ushqimi, veshmbathja, medikamentet dhe siguria, shërbime që konsiderohen se janë përgjegjësi e institucioneve shtetërore.<sup>104</sup> Më tej, një

94 Diskutim në grupin e fokusit në Gjilan, 13 maj 2022. Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë.

95 Diskutim në grupin e fokusit në Klokot, 31 maj 2022. Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë.

96 Intervistë e QKSS-së me përfaqësues të Strehimores për të mbijetuarat të dhunës në familje në Pejë, qershor 2022.

97 Intervistë e QKSS-së me përfaqësues të Strehimores për të mbijetuarat të dhunës në familje në Pejë, qershor 2022.

98 Diskutim në grupin e fokusit në Drenas, 16 shtator 2022. Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë.

99 Diskutim në grupin e fokusit në Drenas, 16 shtator 2022. Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë.

100 Po aty.

101 Diskutim në grupin e fokusit në Mitrovicë, 19 prill 2022. Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë.

102 Intervistë me përfaqësues të Strehimores për të mbijetuarat të dhunës në familje në Ferizaj, 7 qershor 2022, Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë.

103 Po aty.

104 Intervistë me përfaqësues të Strehimores për të mbijetuarat të dhunës në familje në Gjakovë, Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë, qershor 2022.

përfaqësues nga strehedorja për të mbijetuarat e dhunës në familje në Pejë thekson se, "ne nuk kemi sigurim, madje edhe si staf ndihemi të pasigurt dhe në rrezik prej dhunuesve që na përndjekin. Lokacioni i strehedorës është mjaft publik dhe i njohur për vozitësit e taksive. Fakti që dhunuesit na njohin është shumë problematik, sepse na është dashur të takohemi me ta gjatë proceseve të ndryshme ligjore që po kalonin me të mbijetuarën."<sup>105</sup>

Me tutje, theksojnë se, "burokracia është shumë problematike, ne duhet të aplikojmë si projekt në MFPT, si OJQ, çdo vit dhe çdo vit kemi të njëjtin projekt. Ndonjëherë thirrja për propozime hapet vonë, me vonesa shtesë derisa të merret një vendim, dhe ne humbim kohë kritike për 2-3 muajt e parë të vitit – duke na lënë pa paga dhe fonde për mirëmbajtjen e strehedorës."<sup>106</sup> Për ta adresuar këtë sfidë, përfaqësuesi i strehedorës në Ferizaj sugjeron se, "do të ishte më e përshtatshme që kjo çështje të rregullohej përmes licencimit, pasi që ne duhet të licencohemi çdo tre vjet, do të ishte mirë që ne të siguronim financim për të paktën tre vjet në momentin që marrim licencë."<sup>107</sup> Edhe pse në disa raste komunat ofrojnë disa fonde për strehedorët, mbështetja financiare e ofruar nuk është e rregullt apo e qëndrueshme. Për shembull, në Ferizaj, ndonëse në fillim komuna ka siguruar disa financime për strehedorën, komuna nuk ka ofruar asnjë financim në tre vitet e fundit.<sup>108</sup> Në komunën e Gjilanit, pjesëmarrësit në grupin e fokusit shprehën se, "strehedorja nuk është në gjendje t'i mbrojë të mbijetuarat me risk të lartë, nuk kemi infrastrukturë për të qenë efikas për ta bërë këtë."<sup>109</sup> **Qendrat për Punë Sociale po ashtu përballen me kufizime financiare që sfidojnë disponueshmërinë dhe cilësinë e ofrimit të shërbimeve të tyre** – Siç thekson një përfaqësues nga QPS-ja në Viti, "Nuk kemi fonde të mjaftueshme dhe kjo mbetet një nga barrierat kryesore në ofrimin e shërbimeve më të mira."<sup>110</sup>

**Pandëshkueshmëria për dhunën në baza gjinore dhe dështimet e mbrojtjes institucionale i shtojnë rastet recidiviste që të përshkallëzohen në femicid** – Ka një sërë faktorësh pse manifestime të caktuara të DHBGJ-së janë raste me risk të lartë, si ato që përfshijnë recidivistët ose kriminelët që e kryejnë sërish veprën, shpesh në mënyrë të përsëritur. Rastet e recidivistëve raportohen si të zakonshme, "kemi raste kur e mbijetuara largohet nga strehedorja dhe kthehet sërish pasi ka përjetuar dhunë të përsëritur."<sup>111</sup> Vetëm në Mitrovicë këtë vit, tri gra u vranë nga kryesit recidivistë, duke vënë në dukje një dështim të rëndë institucional.<sup>112</sup> Për shembull, një pjesëmarrëse në grupin e fokusit në Mitrovicë tregoi sa sfiduese është të dish si të reagosh dhe kur. Ajo përmendi se, "gruaja që ka raportuar se i shoqi ka ushtruar dhunë ndaj saj nuk ka qenë plotësisht e sinqertë apo e hapur me zyrtarin e rastit në polici, dhe ajo nuk ka pranuar të shkojë në strehedorë."<sup>113</sup> Më tej, për rastin konkret, djali i të mbijetuarës është shprehur se ai e garantonte sigurinë e nënës së tij, por situata kishte dalë jashtë kontrollit kur burri – pas një mosmarrëveshje me të mbijetuarën – si përfundim e vrau.<sup>114</sup> Tri raste të fundit të femicidit kanë përfshirë

---

105 Intervistë me përfaqësues të Strehedorës për të mbijetuara të dhunës në familje në Pejë, qershor 2022. Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë.

106 Intervistë me përfaqësues të Strehedorës për të mbijetuara të dhunës në familje në Ferizaj, 7 qershor 2022. Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë.

107 Po aty.

108 Po aty.

109 Diskutim në grupin e fokusit në Gjilan, 13 maj 2022. Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë.

110 Diskutim në grupin e fokusit në Viti, 4 mars 2022. Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë.

111 Intervistë me përfaqësues të Strehedorës për të mbijetuara të dhunës në familje në Ferizaj, 7 qershor 2022. Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë.

112 Diskutim në grupin e fokusit në Mitrovicë, 19 prill 2022. Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë.

113 Diskutim në grupin e fokusit në Mitrovicë, 19 prill 2022. Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë.

114 Po aty.

kryes recidivistë, madje “edhe në rastet kur policia e ka kryer punën e saj, të akuzuarit janë liruar pas 48 orësh – me fjalë të tjera, ky trajtim i dobët nga institucionet e drejtësisë vetëm sa i trimëron edhe më shumë kryesit, çka është arsyeja pse ata vazhdojnë të jenë të dhunshëm.”<sup>115</sup>

**Familjet biologjike të grave të mbijetuara të dhunës në familje rrallë janë mbështetëse ndaj të mbijetuarave** – Për shkak të mentalitetit patriarkal në vend, familja biologjike e grave rrallëherë mbështet vendimin e anëtarëve të familjes së tyre për t’i shpëtuar keqtrajtimit dhe për ta lënë burrin dhunues, shpesh për shkak se i shohin fëmijët (kur kanë fëmijë) si përgjegjësi e burrit, duke e detyruar kështu gruan të kthehet tek burri dhunues, i cili në shumë raste është recidivist.<sup>116</sup> Siç vë në dukje një pjesëmarrëse në grupin e fokusit në Podujevë, “një nga faktorët kyç në ofrimin e ndihmës juridike dhe mbështetjes tjetër për të mbijetuarat është që familja e saj biologjike ta pranojë vajzën e vet nëse ajo është keqtrajtuar, dhe të mos ta inkurajojë që të kthehet tek bashkëshorti dhunues. Ka pasur edhe raste kur një grua ka përjetuar dhunë nga burri i saj, madje edhe presion për ta abortuar vajzën e saj që ende e kishte në bark – në këtë rast, familja biologjike e vajzës e ka mbështetur gruan dhe ka ndihmuar në rritjen e foshnjës së saj.”<sup>117</sup>

**Urdhrrat e mbrojtjes të shqiptuar nga gjykata ndonjëherë e përkeqësojnë situatën në rastet e dhunës në familje** – Siç theksojnë përfaqësuesit e Policisë së Kosovës në Drenas, “Urdhrrat e mbrojtjes të shqiptuar nga gjykata nuk garantojnë siguri për të mbijetuarat, pasi që ato duhet të kthehen në të njëjtën shtëpi, në kushte që është në thelb e pamundur të monitorohet distanca siç përcaktohet me ligj; pra problemet janë të pashmangshme”<sup>118</sup> Përfaqësuesit e QPS-së ndajnë gjithashtu të njëjtin shqetësim lidhur me urdhrat e mbrojtjes, të cilët duket se “e humbin qëllimin e tyre në rastet kur palët e përfshira janë në kontakt të ngushtë.”<sup>119</sup>

**Me programe dhe kapacitete të kufizuara riintegrimi, shumica e të mbijetuarave të dhunës në familje të cilëve u mungon pavarësia financiare përfundojnë duke u kthyer tek partnerët e tyre dhunues.** Edhe pse disa të mbijetuara arrijnë të gjejnë punë, të sigurojnë mjete për jetesë të ndarë jashtë strehimores, shumica e grave ende kthehen te kryesi i dhunës për shkak të rrethanave të këqija financiare. Ndër arsyet kryesore që pengojnë fuqizimin ekonomik të të mbijetuarave janë mungesa e pronësisë, mungesa e burimeve alternative të të hyrave dhe fëmijët në ngarkim.<sup>120</sup> Pas kthimit në të njëjtën familje me ish dhunuesin, shumë gra vazhdojnë të jetojnë me frikë dhe të përballen me traumën e përvojës së tyre të jetuar me dhunën.<sup>121</sup> Nga ana tjetër, duke pasur mundësi të kufizuara riintegrimi, disa gra e zgjasin qëndrimin e tyre në strehimore. Në strehimoren për dhunë në familje në Gjilan, theksojnë se, “ndonëse në bazë të rregullores sonë, të mbijetuarat qëndrojnë nga zero deri në 6 muaj, kemi pasur raste kur ato qëndrojnë dy, tri, madje edhe 14 vjet në strehimore.”<sup>122</sup> Edhe në rastet kur bashkëshorti dhunues merret nga policia,

115 Diskutim në grupin e fokusit në Mitrovicë, 19 prill 2022. Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë.

116 Diskutim në grupin e fokusit në Podujevë, 27 prill 2022. Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë.

117 Po aty.

118 Diskutim në grupin e fokusit në Drenas, 16 shtator 2022. Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë.

119 Po aty.

120 Intervistë me përfaqësues të Strehimores për të mbijetuara të dhunës në familje në Gjakovë, Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë, qershor 2022.

121 Po aty.

122 Intervistë me përfaqësues të Strehimores për të mbijetuara të dhunës në familje në Gjakovë, Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë, qershor 2022.

për shkak të mungesës së mundësive të tjera për të siguruar pavarësinë financiare, "të mbijetuarat duhet të kthehen në të njëjtën shtëpi, e cila në shumë raste ndahet me nënën dhe vëllain e dhunuesit.<sup>123</sup>" Megjithëse ndryshimet e fundit në kodin penal për kriminalizimin e DHBGJ-së duket se kanë pasur një efekt frenues, kur të mbijetuarat kanë mundësi të kufizuara riintegrimi, ato vendosin të kthehen në të njëjtën familje me dhunuesin.<sup>124</sup> Një tjetër pjesëmarrëse në grupin e fokusit thekson një çështje tjetër që i rëndon rrethanat financiare të të mbijetuarës. Ajo thekson se, "në rastet kur të mbijetuara përfiton alimentacion, ligji e ndalon përfitimin nga skemat sociale, që do të thotë se në rastet kur nuk paguhet alimentacioni, këto familje mbeten pa burime financimi."<sup>125</sup> Sipas një pjesëmarrësi në grupin e fokusit në Gjilan, institucionet kyçe të përfshira në trajtimin e rasteve të DHBGJ-së nuk janë të vetëdijshme për rolet e tyre dhe peshën e përgjegjësive të tyre. Ai shtoi se, "rehabilitimi dhe riintegrimi i të mbijetuarave është përgjegjësi e institucioneve – nuk mjafton të sigurohet ushqim dhe strehim për të mbijetuarat – ky nuk është fuqizim. Të mbijetuarat duhet të kenë zgjidhje afatgjata dhe qasje në burime të të hyrave."<sup>126</sup>

**Mungesa e vijave buxhetore të ndara për të mbijetuarat e DHBGJ-së paraqet sfida në adresimin e rasteve dhe ofrimin e shërbimeve** – Nëpër komuna, të dhënat tregojnë se punëtorët e vijës së parë dhe institucionet kyçe të mandatuara për trajtimin e rasteve të DHBGJ-së përballen me financim të kufizuar për kryerjen efektive të detyrave të tyre. Për shembull, një pjesëmarrëse në grupin e fokusit në Klinë thekson se, "Zyra që duhet të merret me rastet e DHBGJ-së funksionon në kushte shumë të këqija, ku është e vështirë të trajtohen gratë apo fëmijët të mbijetuara të DHBGJ-së. Ne nuk kemi as buxhet të mjaftueshëm për të siguruar ushqime apo veshje elementare, ndërkohë që ato i raportojnë rastet e tyre në polici dhe marrin rrugën për në strehimore."<sup>127</sup>

**Roli i OSHC-ve mbetet kritik për lehtësimin e ofrimit të shërbimeve dhe mbështetjes për të mbijetuarat** – Punëtorët e vijës së parë, si pjesë e zinxhirit institucional për adresimin e rasteve të DHBGJ-së, përballen me sfida të shumta, duke përfshirë fondet dhe kapacitetet e kufizuara dhe ndonjëherë janë të kufizuar edhe nga marrja e donacioneve të jashtme. Kështu, roli i OJQ-ve të ndryshme si pjesë e shoqërisë civile ka qenë kritik në plotësimin e këtij hendeku ekzistues në shërbime. Për shembull, "ka raste kur ka dhunë që ushtrohet ndaj grave, por ato e fshehin sepse nuk shihnin ndonjë mundësi tjetër; megjithatë, anëtarët e shoqërisë kanë gjetur mënyra t'u gjenden pranë dhe të ndërhyjnë për t'i mbështetur."<sup>128</sup> Megjithëse institucionet publike të ngarkuara me trajtimin e rasteve të DHBGJ-së raportojnë se janë të gatshme të merren me këto raste, ata pajtohen se, "do të kishte qenë shumë më e vështirë të rritej niveli i vetëdijesimit të publikut si dhe të gjendeshin mënyra për të lehtësuar procedurat për tejkalimin e DHBGJ-së, nëse nuk do të kishte pasur mbështetje pre OSHC-ve."<sup>129</sup> Më tej, OJQ-të luajnë një rol të rëndësishëm në lehtësimin e komunikimit ndërmjet akterëve të ndryshëm të përfshirë në trajtimin e DHBGJ-së nëpërmjet mekanizmit të koordinimit institucional. Për shembull, "ka raste kur OJQ-të e mbështesin të mbijetuarën

---

123 Intervistë me përfaqësues të Strehimores për të mbijetuara të dhunës në familje në Prishtinë, Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë. Maj 2022.

124 Intervistë me përfaqësues të Strehimores për të mbijetuara të dhunës në familje në Ferizaj, 7 qershor 2022. Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë.

125 Diskutim në grupin e fokusit në Vushtrri, 25 tetor 2022. Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë.

126 Po aty.

127 Grupi i fokusit i QKSS-së në Klinë, 18 tetor 2022.

128 Po aty.

129 Grupi i fokusit i QKSS-së në Prishtinë, 20 tetor 2022.



përmes financimit të drejtpërdrejtë, qoftë përmes procedurave juridike ose duke siguruar qira për strehim të sigurt.<sup>130</sup>

**Qendrat për Punë Sociale nuk kanë staf sa duhet, janë me financim të pamjaftueshëm dhe shpesh ballafaqohen me kapacitete të kufizuara** – Pjesëmarrësit në diskutimin në grupin e fokusit në komunën e Fushë Kosovës theksuan se, “Mungesa e stafit në QPS ka qenë shumë sfiduese pasi që do të thotë se nuk jemi asnjëherë në gjendje ta përfundojmë ose mbulojmë plotësisht një rast të vetëm.<sup>131</sup>” Për shembull, në Fushë Kosovë, edhe pse rastet e raportuara të dhunës në familje kanë qenë në rritje, numri i stafit ka mbetur i njëjtë

– me kapacitet të kufizuar për ta përballuar volumin më të madh të punës.<sup>132</sup> Mungesa e fondeve adekuate për të lehtësuar ofrimin e shërbimeve është një çështje që u theksua gjatë grupit të fokusit në Drenas, “Ka raste kur të mbijetuarat e dhunës në familje kalojnë më shumë se gjashtë orë në Stacionin Policor dhe personeli i policisë, shpesh me paratë e veta, duhet të blejnë produkte esenciale për të mbijetuarën dhe fëmijët shoqëruar nëse kanë”. “Në QPS, stafi nuk kompensohet për orët shtesë, shumica funksionojnë pa psikologë, dhe stafi ka nevojë për trajnime të specializuara”, sipas një pjesëmarrësi në grup të fokusit në Vushtrri.<sup>133</sup> Sfidë paraqet edhe qarkullimi i stafit dhe transferimi i gabuar i detyrave të punës nga një i punësuar te tjetri, pasi që nuk ka shkëmbim të njohurive apo informacionit dhe si rrjedhojë, anëtarët e stafit mbeten pa të dhëna për këto raste.<sup>134</sup>” Më tej, ka raste kur të mbijetuarat e DHBGJ-së vuajnë edhe nga probleme të shëndetit mendor dhe punëtorët e vijës së parë nuk kanë ekspertizë për t’u marrë me këto raste.<sup>135</sup>

130 Diskutim në grupin e fokusit në Klinë, 18 tetor 2022. Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë.

131 Grupi i fokusit i QKSS-së në Fushë Kosovë, 14 tetor 2022.

132 Po aty.

133 Diskutim në grupin e fokusit në Vushtrri, 20 tetor 2022.

134 Diskutim në grupin e fokusit në Fushë Kosovë, 14 tetor 2022, Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë

135 Po aty.

## Perceptimet për faktorët që ndikojnë në dhunën në baza gjinore (DHBGJ) në Kosovë

---

**Faktorët ose shkaqet e perceptuara që ndikojnë në DHBGJ janë të ngjashme në të gjithë komunat** – Ndër faktorët më të përmendur që e përkeqësojnë DHBGJ-në përfshihen rrethanat e këqija ekonomike, mentaliteti mbizotërues patriarkal, nivele të ndryshme arsimimi mes burrave dhe grave, praktikat e dobëta të raportimit mediatik të DHBGJ-së që nuk e respektojnë të drejtën e të mbijetuarave për privatësi, abuzimin me substanca, ndarjen e pabarabartë të pronës, normalizimin e dhunës, traumën, shpërthimet e mëtejshme të dhunës si pasojë e raportimit të DHBGJ-së, dhe ardhjen e pandemisë COVID-19.<sup>136</sup> Shqetësuese është se xhelozia dhe tradhtia bashkëshortore është një faktor i përmendur zakonisht në komuna të ndryshme, krahas çështjeve të shëndetit mendor.<sup>137 138</sup> Pjesëmarrësit në grupin e fokusit në komunën e Fushë Kosovës theksojnë rrethanat e këqija financiare, abuzimin me drogën dhe alkoolin, stresin e përditshëm.<sup>139</sup> Të tjera vërejnë se edhe edukimi i grave ka luajtur një rol. Konkretisht, "nënat dhe gjyshet tona kanë luajtur një rol në diskriminim, sepse gjithmonë na kanë thënë se duhet ta dëgjojmë burrin tonë dhe se nuk mund ta marrim pronën që duhet t'i takojë vëllait tonë, duke çuar në një qëndrim që e konsideron mashkullin si të paprekshëm."<sup>140</sup> "Sidomos rastet e DHBGJ-së ku kryesit kanë abuzuar me drogë, janë rritur në masë të madhe."<sup>141</sup> "Gratë po bëhen më të guximshme jo vetëm në raportimin e rasteve të DHBGJ-së, por edhe në sfidimin e dominimit shekullor mashkullor. Dhuna fillon kur gratë fillojnë të kërkojnë të drejtat e tyre si rezultat i fuqizimit."<sup>142</sup> Nga ana tjetër, bazuar në të dhënat e anketës të marra përmes Barometrit Kosovar të Sigurisë, shumica e të anketuarve i konsiderojnë kushtet e këqija ekonomike si një nga shkaqet kryesore të dhunës në familje në Kosovë, pasuar nga nivelet e ulëta të arsimit dhe abuzimi me substanca siç ilustron në Figurën 1 më poshtë:

---

136 Diskutim në grupin e fokusit në Viti, 4 mars 2022. Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë

137 Diskutim në grupin e fokusit në Klinë, 18 tetor 2022. Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë

138 Diskutim në grupin e fokusit në Kllokot, 31 maj 2022. Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë

139 Diskutim në grupin e fokusit në Fushë Kosovë, 14 tetor 2022. Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë


140 Diskutim në grupin e fokusit në Suharekë, 2 mars 2022. Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë

141 Intervistë me Strehimoren në Ferizaj, 7 qershor 2022. Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë

142 Diskutim në grupin e fokusit në Gjakovë, 1 prill 2022. Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë

## FIGURA 1 SHKAOQET E PERCEPTUARA TË DHUNËS NË BAZA GJINORE NË KOSOVË, BAROMETRI I SIGURISË NË BALLKANIN PERËNDIMOR 2022

### CILAT DO TË KONSIDERONIT SI SHKAOQET KRYESORE TË RRIJTJES SË RASTEVE TË DHUNËS NË BAZA GJINORE NË KOSOVË?



**Koordinimi ndërinstytucional për rastet e DHBGJ-së dhe reagimi komunal ndryshon sipas komunës, pa monitorim dhe vlerësim konsistent të punës së tyre. Sfidat shtesë përfshijnë mungesën e mbështetjes nga kryetarët e komunave dhe sigurimin e akomodimit për të mbijetuarat pas largimit nga strehimoret.** Policia e Kosovës ka një njësi speciale për trajtimin e të mbijetuarave të dhunës në baza gjinore. Kur një rast raportohet në polici, zakonisht është i pranishëm edhe një mbrojtës i të mbijetuarës dhe më pas të mbijetuarës i ofrohet mbrojtja e të mbijetuarës, ku përgatitet kërkesa për urdhër të mbrojtjes të shqiptuar nga gjykata; shpeshherë <sup>143</sup> ka dy lloje të urdhrave të mbrojtjes të shqiptuara nga gjykata, të përkohshme dhe emergjente. <sup>144</sup> PK-ja mund të lëshojë urdhra për mbrojtje emergjente dhe t'i vizitojë të mbijetuarat në shtëpitë e tyre. <sup>145</sup> Në rast se kryesi e shkel urdhrin e mbrojtjes, ai mund të akuzohet për një vepër tjetër ose të arrestohet me akuza shtesë. <sup>146</sup> Komuna lokale ka më shumë rol koordinues dhe nganjëherë siguron fonde për strehimoret. <sup>147</sup> Mbrojtësi i viktimave i përfaqëson të mbijetuarat e krimeve në baza gjinore në të gjitha procedurat ligjore. <sup>148</sup> Strehimorja mban një barrë të madhe, por atyre u mungojnë mekanizmat monitorues të punës së tyre. <sup>149</sup>

Në anën tjetër, në komunën e Vitisë, pjesëmarrësit në grupin e fokusit theksojnë se, "ka raste kur dhuna në familje përsëritet dhe prokuroria e merr parasysh, deri më tani nuk kemi pasur raste që kanë përfunduar me fatalitet në komunën tonë." <sup>150</sup> Më tej, në Viti, komuna ka ndërmarrë disa masa për të lehtësuar koston e ofrimit të shërbimeve për të mbijetuarat e dhunës në familje dhe fëmijët e tyre, duke përfshirë marrëveshjen me strehimoren për

143 Diskutim në grupin e fokusit në Gjakovë, 1 prill 2022. Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë.

144 Diskutim në grupin e fokusit në Gjakovë, 1 prill 2022. Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë.

145 Diskutim në grupin e fokusit në Podujevë, 27 prill 2022. Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë.

146 Po aty.

147 Diskutim në grupin e fokusit në Gjiilan, 13 maj 2022. Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë.

148 Po aty.

149 Diskutim në grupin e fokusit në Gjiilan, 13 maj 2022. Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë.

150 Diskutim në grupin e fokusit në Viti, 4 mars 2022. Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë.

të mbijetuarat e dhunës në familje për të ofruar mbështetje financiare në përpjesëtim me numrin e rasteve të dhunës në baza gjinore në komunë.<sup>151</sup> Një çështje tjetër lidhet me trendet e raportimit nga grupet e komuniteteve jo-shumicë dhe pengesat administrative. Konkretisht, sfidë për adresimin e rasteve të dhunës në familje në komunën e Klllokotit është mospërdorimi i numrit lokal nga komuniteti serb, çka që e vështirëson punën e policisë për shkak të pamundësisë për lidhje me këtë grup të qytetarëve.<sup>152</sup> Për më tepër, ka pasur raste kur policia e Kosovës është ballafaquar me sfida në komunikimin me QPS-të, pasi që këto të fundit nuk kompensohen për të punuar jashtë orarit – kështu, me rastet e DHBGJ-së që vijnë gjatë gjithë kohës, të mbijetuarat nuk mund të kenë kontakt të menjëhershëm me punëtorët socialë.<sup>153</sup> Në komunën e Novobërdës, në strehimoren që mbron të mbijetuarat serbe të dhunës në familje, theksojnë nevojën që të trajtohen punëtorët e rinj socialë dhe të koordinohen më mirë mekanizmat institucionalë për trajtimin e rasteve të DHBGJ-së.<sup>154</sup>

**Qëndrimet problematike të punëtorëve të vijës së parë të karakterizuar nga paragjykimet ndaj të mbijetuarave, e sfidojnë efikasitetin e trajtimit të rasteve të DHBGJ-së.** Një përfaqësues i strehimores për të mbijetuarat e dhunës në familje është shprehur se, "QPS-të janë hallka më e dobët në zinxhirin e palëve të interesit, duke e prishur punën bashkëpunuese të institucioneve të përfshira. QPS-të janë thellësisht paragjykuese, atyre u mungojnë anëtarët esenciale të stafit dhe shpesh herë përkrahin dhunuesit."<sup>155</sup> Duke qenë se QPS-të janë institucionet e dyta që reagojnë në rastet e DHBGJ-së menjëherë pas policisë, dhe janë në kontakt me të mbijetuarën dhe dhunuesin, roli i tyre është vendimtar.<sup>156</sup> "Shumicën e kohës punëtorët socialë anojnë në favor të dhunuesit. Ka raste kur QPS-ja përpigjet ta bindë të mbijetuarën që të kthehet në shtëpinë e vet (burimet e keqtrajtimit) në vend që të shkojë në strehimore, praktikë kjo që është në kundërshtim me Konventën e Stambollit", shtojnë ata. Kur u pyetën nëse të pasurit e më shumë anëtareve të stafit femra do të ndikonte në shkallë më të madhe të raportimit të DHBGJ-së, një përfaqësues i QPS-ve u shpreh se, "nuk kemi nevojë për më shumë gra punëtore, kemi mjaftueshëm; dhe [të mbijetuarat] le ta raportojnë dhunën kur ajo përkeqësohet, jo vetëm për një shuplakë."<sup>157</sup> Ky qëndrim shumë problematik nga punëtorët e vijës së parë, të cilët kanë për detyrë t'i mbrojnë të mbijetuarat, paraqet një sfidë të rëndë në trajtimin e DHBGJ-së. Këta punëtorë socialë i dekurajojnë të mbijetuarat që ta raportojnë përvojën e tyre të dhunës, duke e rritur më tej riskun që rastet e DHBGJ-së të përfundojnë në femicid.

**Qëndrimet arsyetuese të dhunës nga Policia e Kosovës dhe prokuroria e dëmtojnë edhe më tej besimin e të mbijetuarave në institucione si subjekte të ngarkuara me garantimin e të drejtave të tyre.** Një pjesëmarrëse në grupin e fokusit diskutoi një rast që u raportua në polici, "një grua që kishte përjetuar dhunë për 13 vjet rresht, kur po intervistohet nga prokuroria, u pyet 'si po e denonconi burrin tuaj për një shuplakë'", duke demonstruar zhgënjim me trajtimin e gabuar të rasteve të DHBGJ-së dhe duke pohuar se, "në këtë rast prokurori duhet të ishte raportuar edhe për dhunë psikologjike."<sup>158</sup> Pjesëmarrësit nga policia në grupin e fokusit në komunën e Klllokotit po ashtu demonstruan qëndrime

---

151 Diskutim në grupin e fokusit në Viti, 4 mars 2022. Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë.

152 në grupin e fokusit në Klllokot, 30 shtator 2022. Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë.

153 Diskutim në grupin e fokusit në Vushtrri, 25 tetor 2022. Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë.

154 Grupi i fokusit në Fushë Kosovë, 14 tetor 2022. Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë.

155 Intervistë me përfaqësues të Strehimores për të mbijetuarat të dhunës në familje në Prishtinë, Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë. Maj 2022.

156 Po aty.

157 Diskutim në grupin e fokusit në Fushë Kosovë, 14 tetor 2022. Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë.

158 Diskutim në grupin e fokusit në Kamenicë, 25 maj 2022. Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë.

problematike ndaj të mbijetuarave të DHBGJ-së përmes deklaratave të tilla si “madje edhe gratë kanë ndryshime, nuk do të fajësoja vetëm meshkujt”, ndërsa përfaqësuesi nga zyrës për komunitete dhe kthim ushtri trysni të tërthortë që gratë pjesëmarrëse në grup të fokusit të mos ishin aktive në diskutim.<sup>159</sup> Për më tepër, përfaqësuesit e policisë nga komuna e Kllokotit nuk kishin njohuri të plota se si procedohet një rast i dhunës në familje dhe pjesëmarrësit e tjerë në grupe të fokusit folën për rastet kur zyrtarët policorë e kanë kritikuar të mbijetuarën e dhunës në familje dhe i kanë thënë se duhet t’i vijë marre për denoncimin e bashkëshortit të saj dhe anëtarëve të tjerë të familjes për DHBGJ.<sup>160</sup>

**QPS-të dhe strehimoret përballen me sfida në adresimin adekuat të nevojave të të mbijetuarave.** Siç vë në dukje përfaqësuesi i PK-së, “ne e dërgojmë të mbijetuarën kur të vendosë ajo dhe në rastet kur duan të kthehen te bashkëshorti i tyre ua lejojmë.”<sup>161</sup> Kjo qasje konsiderohet problematike pasi që nuk merr në konsideratë asnjë masë të vlerësimit të riskut, duke i kthyer të mbijetuarat në një mjedis që i vendos ato në kushte potencialisht të pasigurta. Për më tepër, siç thekson një përfaqësues i QPS-së në Pejë, “ne mbajmë seanca me bashkëshortët për ta kuptuar më mirë se ku qëndron problemi dhe për t’i pajtuar familjet nëse kjo është e mundur.”<sup>162</sup> Në disa raste, prokuroria përcakton nivelin e riskut me të cilin përballen të mbijetuarat dhe më pas vendosin nëse duhet të dërgohen në strehimore apo jo.

**Dhuna psikologjike dhe dhuna ekonomike janë dy lloje të dhunës në baza gjinore që janë më të vështira për t’u identifikuar dhe trajtuar , por janë ende të përhapura.**

– Ekziston një besim i përhapur se në përgjithësi niveli i vetëdijesimit rreth DHBGJ-së dhe nevojës për raportim të saj ka ardhur në rritje. Siç vë në dukje një pjesëmarrëse në grupin e fokusit, “Rritja e rasteve të raportuara të DHBGJ-së vjen si rezultat i rritjes së nivelit të vetëdijesimit, megjithatë dhuna psikologjike mbetet shumë e vështirë për t’u zbuluar. Dhuna ekonomike mbetet gjithashtu problematike dhe është një nga veprat e DHBGJ-së që raportohet më së paku.<sup>163</sup>” Një përfaqësues i strehimores për të mbijetuarat e dhunës në familje në Prishtinë thekson se, “dhuna psikologjike dhe dhuna ekonomike janë format më të zakonshme të DHBGJ-së që i shohim kohët e fundit.”<sup>164</sup>

**Fushatat për vetëdijesim kanë një ndikim të drejtpërdrejtë në rritjen e shkallës së raportimit** – Bazuar në të dhënat e mbledhura, është theksuar se ndikimi i fushatave për vetëdijesim është mjaft i shpejtë në rritjen e niveleve të raportimit të rasteve të DHBGJ-së.

Siç thekson një pjesëmarrëse në grupin e fokusit në komunën e Ferizajt, “gjatë pandemisë kemi organizuar ligjërata në shkolla të mesme për dhunën në baza gjinore dhe kemi parë një rritje të dukshme të rasteve të raportuara.”<sup>165</sup> Më tej, shton se, “pothuajse pas çdo takimi informues dikush na është drejtuar me pyetje se si mund t’i raportojnë rastet e DHBGJ-së, pasi që shumica e tyre as që ishin në dijeni që ofrimi i strehimit ofrohet si shërbim.”<sup>166</sup>

159 Diskutim në grupin e fokusit në Kllokot, 30 shtator 2022. Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë.

160 Po aty.

161 Grupi i fokusit i QKSS-së në Pejë, 20 shtator 2022. Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë.

162 Po aty.

163 Diskutim në grupin e fokusit në Kamenicë, 25 maj 2022. Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë.

164 Intervistë me përfaqësues të Strehimores për të mbijetuarat të dhunës në familje në Prishtinë, Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë. Maj 2022.

165 Intervistë me përfaqësues të Strehimores për të mbijetuarat të dhunës në familje në Ferizaj, 7 qershor 2022. Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë.

166 Po aty.

## Perspektivat për rehabilitim dhe riintegrim për të mbijetuarat e dhunës në baza gjinore

---

**Riintegrimi i të mbijetuarave të DHBGJ-së konsiderohet sfidë urgjente për strehimoret dhe QPS-të** – Tranzicioni i sigurt i të mbijetuarave të DHBGJ-së në shoqëri dhe riintegrimi i tyre konsiderohet si një nga sfidat më të mëdha në komunën e Vushtrrisë.<sup>167</sup> Komuna duhet të punojë shumë për të ofruar zgjidhje afatgjata për akomodim për gratë, dhe mënyra kryesore për ta bërë këtë është përmes punësimit.<sup>168</sup> **Strehimoret ofrojnë vetëm një zgjidhje afatshkurtër, pasi që të mbijetuarat e dhunës në familje kërkojnë një qasje më afatgjatë ndaj riintegrit** – Meqenëse strehimoret raportohen si të nenfinacuara dhe me burime të papërshtatshme financimi, nëpër komuna është theksuar se të mbijetuarat e DHBGJ-së kërkojnë zgjidhje afatgjatë kur bëhet fjalë për banimin. Strehimoret afatshkurtra nuk i bëjnë të ndihen të sigurt, ndërkohë që "strehimi i ofruar nga shteti si pjesë e skemave sociale do t'u garantonte të mbijetuarave që DHBGJ-ja nuk do të përsëritej."<sup>169</sup> **Më tej, kushtet e këqija ekonomike e pengojnë zgjidhjen e duhur të rasteve të dhunës në familje** – Siç vë në dukje një pjesëmarrëse në grupin e fokusit në Drenas, "Ka raste kur familja e të akuzuarve për dhunë në familje kanë kërkuar lirim dhe të burgosurve për shkak të rrethanave të tyre të këqija ekonomike; pra, ka raste kur deklarata [e të mbijetuarës] ndryshohet për shkak të rrethanave sfiduese financiare dhe kryesi është burimi kryesor i tyre për mbijetesë ekonomike."<sup>170</sup>

**Sfidë paraqet edhe mungesa e programeve për rehabilitim për fëmijët që kanë përjetuar drejtpërdrejt ose tërthorazi dhunë në familje.** Një çështje që bie në sy është mungesa e psikologëve në Qendrat për Punë Sociale dhe në shkolla, për t'i trajtuar rastet e dhunës në familje. Siç vë në dukje një pjesëmarrës në diskutimin në grupin e fokusit në komunën e Fushë Kosovës, "nuk ka psikologë në QPS dhe në shkolla që nevojiten për t'i trajtuar fëmijët që janë të mbijetuara të dhunës në familje ose vijnë nga familje që kanë përjetuar dhunë në familje."<sup>171</sup> Stigma që lidhet me përdorimin e shërbimeve mbështetëse të shëndetit mendor e rëndon më tej sfidën. Megjithatë, edhe nëse fëmijët duan të shkojnë tek psikologu, kjo është e vështirë duke qenë se, për shembull, ka 11,000 nxënës dhe vetëm një psikolog.<sup>172</sup> Edhe për strehimoret për të mbijetuarat e dhunës në familje, adresimi i nevojave të fëmijëve paraqet sfidë. Siç thekson përfaqësuesja e strehimores për të mbijetuarat e keqtrajtitimit në familje në Prizren, "çështja më e madhe për ne është të merremi me fëmijët kur nënat e tyre janë të mbijetuara të dhunës në familje. Fëmijët kanë shumë kërkesa dhe nuk e përballojnë mirë izolimin brenda strehimores; shumica e tyre e ndërpresin shkollimin kur janë të izoluar, çka ua shton më tej sikletin."<sup>173</sup> Më tej, siç vëren një psikolog në një strehimore, "edhe fëmijët janë të mbijetuar dhe trauma që ata përjetojnë

---

167 Diskutim në grupin e fokusit në Vushtrri, 25 tetor 2022. Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë.

168 Diskutim në grupin e fokusit në Klinë, 18 tetor 2022. Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë.

169 Focus Group Discussion in Vushtrri, October 20, 2022. Kosovar Centre for Security Studies.

170 Diskutim në grupin e fokusit në Kamenicë, 25 maj 2022. Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë.

171 Grupi i fokusit i QKSS-së në Fushë Kosovë, 14 tetor 2022. Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë.

172 Po aty.

173 Intervistë me përfaqësues të Strehimores për të mbijetuara të dhunës në familje në Prizren, Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë, maj 2022.

si dëshmitarë të dhunës në familje shpesh manifestohet si dhunë në shkollë ose forma të tjera të manifestimeve të traumës.<sup>174</sup>

**Të mbijetuarat e DHBGJ-së janë më ngurruese për të kërkuar shërbime mbështetëse të shëndetit mendor, duke i sfiduar perspektivat e tyre për rehabilitim dhe riintegrim**

– Edhe pse të mbijetuarat e DHBGJ-së kanë njëfarë qasje në shërbimet mbështetëse të shëndetit mendor, si p.sh. përmes psikologëve në strehimoret për të mbijetuarat e keqtrajtimin në familje, ato përballen me pengesa në qasjen në këto shërbime. Ka raste kur këto pengesa përfshijnë frikën e stigmës nga komuniteti që lidhet me trajtimin nga një psikolog ose të moskuptuarit e vlerës së vizitës tek një psikolog. Për shembull, në komunitetin e vogël të Komunës së Kamenicës, të mbijetuarat e dhunës në familje e njohin psikologun dhe ngurrojnë ta vizitojnë sepse të mbijetuarat nuk ndihen rehat të ndajnë informacione të caktuara me të.<sup>175</sup> Në raste të tjera, ka mungesë të psikologëve klinikë që janë më të specializuar për trajtimin e rasteve të DHBGJ-së. Siç thekson një përfaqësues i QPS-së, “të mbijetuarat marrin të gjitha trajtimet që ne i kemi për t’ua ofruar, megjithatë, ne përballemi me vështirësi për t’i bindur që të shkojnë tek psikologu.<sup>176</sup>”

**Shërbimet e kujdesit ditor për fëmijë janë një faktor i rëndësishëm në mbështetjen e rehabilitimit dhe riintegrimin të të mbijetuarave të dhunës në familje.**

Një sfidë që u identifikua për sa i përket nevojës për të lehtësuar rehabilitimin dhe riintegrimin e të mbijetuarave, ka qenë mungesa e shërbimeve të çerdhes për fëmijët që vijnë nga histori të dhunës në familje. Siç vë në dukje një pjesëmarrëse në grupin e fokusit në Fushë Kosovë, “edhe në rastet kur ne jemi në gjendje ta mbështesim punësimin e grave të mbijetuara të keqtrajtimin në familje, ato nuk janë në gjendje të punojnë sepse nuk kanë si të kujdesen për fëmijët e tyre.<sup>177</sup>”

174 Po aty.

175 Diskutim në grupin e fokusit në Kamenicë, 25 maj 2022. Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë.

176 Po aty.

177 Po aty.

# REKOMANDIME

---

Është evidente nga rastet e raportuara si dhe nga këndvështrimi i komunitetit se dhuna në baza gjinore paraqet një kërcënim serioz, duke ndikuar në mënyrë disproporcionale në jetën dhe sigurinë e grave dhe vajzave. Përveç identifikimit të disa prej sfidave kryesore në adresimin e rasteve të dhunës në baza gjinore, ky studim parashton një sërë rekomandimesh që rrjedhin ekskluzivisht nga intervistat dhe diskutimet në grupe të fokusit. Këto rekomandime përfshijnë sa më poshtë vijon:

## **Të realizohen fushata për vetëdijesim për kërcënimin e DHBGJ-së, si të raportohet kjo dhunë, dhe ku munden të kërkojnë ndihmë të mbijetuarat e DHBGJ-së**

Duhet bërë përpjekje më të mëdha për ta informuar më mirë publikun dhe për të rritur vetëdijesimin në lidhje me DHBGJ-në. Pikë së pari, publikut dhe të mbijetuarave të DHBGJ-së u mungojnë informatat se si ta raportojnë dhunën dhe cilat janë institucionet që mund të ofrojnë mbështetje ose strehim për rastet e DHBGJ-së. Meqenëse shumica e të anketuarve nënvizon nevojën për të trajtuar trendin shqetësues se si dhuna ndaj grave duket se është 'normalizuar', propozohet që fushatat për vetëdijesim të fillojnë që herët në sistemin arsimor, duke përfshirë ligjëratat e rregullta për DHBGJ-në nga policia dhe OSHC-të në shkolla. Për më tepër, fushatat për vetëdijesim duhet të kenë shtrirje më të madhe dhe të zbatohen në mbarë vendin, duke përfshirë pjesët rurale të Kosovës dhe duke përfshirë jo vetëm gratë dhe vajzat, por edhe burrat dhe djemtë. Si pjesë e këtyre përpjekjeve për vetëdijesim, duhet theksuar se çdo anëtar i shoqërisë e luan një rol në trajtimin e DHBGJ-së ose parandalimin e saj, dhe kjo mund të bëhet edhe duke inkurajuar raportimin e DHBGJ-së nga 'faqinjët' ose individë të tjerë që mund të mos preken drejtpërdrejt. Kjo potencialisht do ta forconte efektin parandalues të raportimit dhe gjithashtu do të dërgonte një sinjal se DHBGJ-ja është e papranueshme dhe nuk do të tolerohet. Për fundi, përveç informimit të publikut se si të kërkohet ndihmë për parandalimin ose raportimin e DHBGJ-së, publiku duhet gjithashtu të informohet më mirë për rëndësinë e respektimit të së drejtës së barabartë të grave për trashëgiminë pronësore, e cila është e lidhur ngushtë me varësinë e tyre ekonomike e që më pas i vë në pozitë më të pasigurt për DHBGJ. Më tej, bazuar në të dhënat e anketës të mbledhura përmes Barometrit të Sigurisë në Ballkanin Perëndimor, përmirësimi i nivelit të arsimit dhe zbatimi i fushatave për vetëdijesim për DHBGJ-në në mbarë qytetet dhe shkollat janë identifikuar si masa kyçe të nevojshme për parandalim të dhunës në familje.<sup>178</sup>

## **Duhet t'i jepet fund pandëshkueshmërisë për kryesit e DHBGJ-së dhe ata që kryejnë krime të DHBGJ-së duhet të përballen me dënime më të ashpra. Rastet recidiviste duhet të trajtohen më seriozisht, përfshirë edhe përmes programeve për rehabilitim që synojnë uljen e riskut të tyre për përsëritje të veprës.**

Rastet recidiviste duhet të trajtohen më seriozisht, përfshirë edhe përmes programeve për rehabilitim që synojnë uljen e riskut të tyre për përsëritje të veprës, si dhe të bëhet monitorimi elektronik i tyre, përmes pajisjeve elektronike. Të anketuarit sugjerojnë se fillimisht duhet të krijohet një bazë kombëtare e të dhënave e hapur për publikun në lidhje me identitetin e kryesve të akuzuar për krime të DHBGJ-së, duke përfshirë ngacmimin seksual dhe dhunën seksuale. Në rastet kur kryesit e DHBGJ-së lirohen nga burgu ose e mbarojnë dënimin, duhet t'i nënshtrohen

---

178 Barometri i Sigurisë në Ballkanin Perëndimor, 2022. Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë.



trajtimin për rehabilitim. Konkreisht duhet të krijohet një qendër për rehabilitimin e kryesve të DHBGJ-së. Nuk mjafton dërgimi i të mbijetuarave në strehimore, por kryesit duhet gjithashtu t'i nënshtrohen një lloj trajtimi që potencialisht mund ta ulë shkallën e recidivizmit.

**Duhet të ketë masa më të mëdha mbrojtëse dhe garanci për të drejtat e të mbijetuarve të dhunës në familje, me fokus në fuqizimin dhe pavarësinë e tyre ekonomike.** Një gjetje konsistente e ndarë mes të anketuarve ka qenë lidhja mes nivelit të arsimit, qasjes në pronë dhe pavarësisë financiare të të mbijetuarave të DHBGJ-së. Kështu, rekomandohet që strehimoret ta fokusojnë programimin e tyre në riintegrimin e të mbijetuarave përmes programeve që i fuqizojnë ato ekonomikisht. Kjo mund të jetë gjithashtu një hapësirë ku donatorët vendorë ose ndërkombëtarë mund t'i mbështesin strehimoret lokale për të mbijetuarat e dhunës në familje. Është me rëndësi të ketë edhe programe për fëmijët që po rriten në mjedise të karakterizuara nga dhuna dhe të cilët mund të kenë nevojë për mbështetje të shëndetit mendor, si dhe programe riintegrimi dhe risocializimi.

**Është urgjente që institucionet e nivelit qendror dhe lokal të ndajnë vija të veçanta buxhetore të dedikuara për adresimin e rasteve të DHBGJ-së, duke përfshirë financimin e QPS-ve, policisë lokale dhe strehimoreve për të mbijetuarat e dhunës në familje.** Institucionet lokale duhet të marrin një rol më të madh në trajtimin e rasteve të DHBGJ-së. Çdo komunë duhet të ketë të paktën një strehimore për mbrojtje të të mbijetuarave të DHBGJ-së, pa pasur nevojë të mbështetet në strehimoret rajonale të cilave u mungon financimi dhe janë të mbipopulluara dhe të paafta për t'i adresuar nevojat e atyre që kërkojnë ndihmë.

# PËRFUNDIME

---

Edhe pse dhuna në baza gjinore paraqet një çështje komplekse dhe sfiduese, në të njëjtën kohë konsiderohet një problem i parandalueshëm nëpërmjet programimit të fortë institucional për dhunën në baza gjinore (d.m.th. parandalimi dhe reagimi) dhe zbutjes së riskut në të gjithë sektorët.<sup>179</sup> Më konkretisht, dhuna në baza gjinore konsiderohet e parandalueshme përmes një kombinimi të "identifikimit të hershëm të grave të prekura nga dhuna, qasjes në mbështetje dhe mbrojtje me të mbijetuarat në qendër, duke siguruar që policia dhe sistemet e drejtësisë të jenë më reaguese ndaj nevojave të të mbijetuarave dhe që parandalimi parësor adreson shkaqet rrënjësore të dhunës ndaj grave dhe vajzave, duke përfshirë transformimin e maskuliniteteve të dëmshme, normave sociale, eliminimin e pabarazive strukturore gjinore dhe stereotipeve gjinore"<sup>180</sup>. Më tej, forcimi i mbledhjes së të dhënave për femicidet është një hap kritik për të informuar politikën dhe programet që synojnë parandalimin dhe eliminimin e dhunës ndaj grave dhe vajzave. Në kontekstin e një kornize solide ligjore dhe strategjike për adresimin e rasteve të dhunës në baza gjinore, prioritizimi i çështjes nga qeveria e Kosovës dhe ndarja e fondeve adekuate për mekanizmat përkatës koordinues, janë hapat e parë kritikë për adresimin e kësaj fatkeqësie për gratë në Kosova.

---

179 "Dhuna në baza gjinore", UNHCR, qasur përmes: <https://www.unhcr.org/gender-based-violence.html>.

180 UN Women, "Njoftim për shtyp: Gratë dhe vajzat janë në risk më të madh që t'i vrasin në shtëpi, tregon raporti i ri për femicidet i UNODC dhe UN Women", qasur përmes <https://www.unwomen.org/en/news-stories/press-release/2022/11/press-release-women-and-girls-are-more-at-risk-to-be-killed-at-home-new-unodc-and-un-women-report-on-femicide-shows#:~:text=New%20York%20%E2%80%94%20new%20study,their%20own%20family%20in%202021>.

# REFERENCAT

---

1. "Rastet e dhunës në familje janë në rritje", Radio Evropa e Lirë, 2022. Qasur në: <https://www.evropaelire.org/a/dhuna-ne-familje-/32004188.html>.
2. "Femicidi", Instituti Evropian për Barazi Gjinore, qasur përmes: <https://eige.europa.eu/thesaurus/terms/1128>
3. "Dhuna në baza gjinore", UNHCR, qasur përmes <https://www.unhcr.org/gender-based-violence.html>.
4. "Ligji Nr. 03/L –182 për mbrojtje kundër dhunës në familje", Kuvendi i Republikës së Kosovës, 2010. Qasur në: <http://old.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2010-182-eng.pdf>.
5. "Mbi 2.200 raste të dhunës në familje deri në tetor", Koha.net, 2022. Qasur përmes: <https://www.koha.net/arberi/357535/mbi-2-200-raste-te-dhunes-ne-familje-deri-ne-tetor/>.
6. "Strategjia Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave 2022– 2026", Ministria e Drejtësisë, Qeveria e Kosovës, 2022. Qasur përmes: <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/08/ENG-Strategjia-Kombetare-per-Mbrojtje-nga-Dhuna-ne-Familje-dhe-Dhuna-ndaj-Grave-2022-2026.pdf>.
7. Adelina Ahmeti, "Në Kosovë, sistemi dështon në mbrojtjen e të mbijetuarave të keqtrajtimit në familje", Balkan Insight, 2021. Qasur përmes <https://balkaninsight.com/2021/04/06/in-kosovo-system-failing-to-protect-domestic-abuse-victims/>.
8. Aleksandar Brezar, "A është vrasja brutale e Marigona Osmanit pikë kthese për shoqërinë kosovare?", Uncovering Europe, 2021. Qasur përmes: <https://www.euronews.com/my-europe/2021/09/02/is-the-brutal-murder-of-marigona-osmani-a-tipping-point-for-kosovan-society>.
9. Ardita Zeqiri, "Protesta në Prishtinë pas vrasjes së gruas shtatzënë në oborrin e spitalit", Prishtinë Insight, 2022. Qasur përmes: <https://prishtinainsight.com/protest-in-prishtina-after-pregnant-womans-murder-in-hospital-courtyard/>.
10. Besa Luci, "Vrasja e Marigonës", Kosovo 2.0, 2022. Qasur përmes: <https://kosovotwopointzero.com/en/the-murder-of-marigona/>.
11. Të zënë ngushtë: sfidat e Kosovës në përballjen me pandeminë COVID-19", Avdimetal et. al., dhjetor, 2020, qasur përmes <https://qkss.org/en/publikimet/te-zene-ngushte-sfidat-e-kosoves-ne-perballjen-me-pandemine-covid-19>.
12. Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (Konventa e Stambollit), Këshilli i Evropës, 2022. Qasur përmes: <https://www.coe.int/en/web/istanbul-convention/>.
13. Diskutim në grupin e fokusit në Mitrovicë, 19 prill 2022. Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë.
14. Diskutim në grupin e fokusit në Viti, 4 mars 2022. Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë.
15. Diskutim në grupin e fokusit në Drenas, 16 shtator 2022. Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë.
16. Diskutim në grupin e fokusit në Kllokot, 31 maj 2022. Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë.
17. Diskutim në grupin e fokusit në Gjakovë, 1 prill 2022. Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë.
18. Diskutim në grupin e fokusit në Klinë, 18 tetor 2022. Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë.
19. Diskutim në grupin e fokusit në Gjilan, 13 maj 2022. Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë.
20. Diskutim në grupin e fokusit në Kamenicë, 25 maj 2022. Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë.

21. Diskutim në grupin e fokusit në Podujevë, 27 prill 2022. Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë.
22. Diskutim në grupin e fokusit në Vushtrri, 20 tetor 2022.. Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë.
23. Diskutim në grupin e fokusit në Suharekë, 2 mars 2022. Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë.
24. Diskutim në grupin e fokusit në Fushë Kosovë, 14 tetor 2022. Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë.
25. Intervistë me përfaqësues të Strehimores për të mbijetuara të dhunës në familje në Gjilan, Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë, qershor 2022.
26. Intervistë me përfaqësues të Strehimores për të mbijetuara të dhunës në familje në Ferizaj, 7 qershor 2022. Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë.
27. Intervistë me përfaqësues të Strehimores për të mbijetuara të dhunës në familje në Pejë, Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë, qershor 2022.
28. Intervistë me përfaqësues të Strehimores për të mbijetuara të dhunës në familje në Gjakovë, Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë, qershor 2022.
29. Intervistë me përfaqësues të Strehimores për të mbijetuara të dhunës në familje në Prizren, Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë, maj 2022.
30. Intervistë me përfaqësues të Strehimores për të mbijetuara të dhunës në familje në Prishtinë, Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë. Maj 2022.
31. Intervistë me përfaqësues të Strehimores për të mbijetuara të dhunës në familje në Mitrovicë, Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë, qershor 2022.
32. "Raporti për Kosovën 2021", Politika Evropiane e Fajnjësisë dhe Negociatat e Zgjerimit, Komisioni Evropian, 2021. Qasur përmes [https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/kosovo-report-2021\\_en](https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/kosovo-report-2021_en).
33. Shajpe Gjocaj, "SHLYERJA E GRAVE TË VRARA TË KOSOVËS", Kosovo 2.0, 2020. Qasur përmes: <https://kosovotwopointzero.com/en/the-herasure-of-kosovos-murdered-women/>
34. UN Women, "Njoftim për shtyp: Gratë dhe vajzat janë në risk më të madh që t'i vrasin në shtëpi, tregon raporti i ri për femicidet i UNODC dhe UN Women", qasur përmes <https://www.unwomen.org/en/news-stories/press-release/2022/11>.
35. përmes [https://eu.boell.org/sites/default/files/mexico\\_lima.pdf](https://eu.boell.org/sites/default/files/mexico_lima.pdf).
36. "Barometri i Sigurisë në Ballkanin Perëndimor 2022", Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë.

**Disclaimer:** The development and publication of this document has been supported by the Kosovo Foundation for Civil Society (KCSF) program 'EJA Kosovo', co-financed by the Swiss Agency for Development and Cooperation (SDC), Sweden, and the Government of the Grand Duchy of Luxembourg. The content of this document is the responsibility of Kosovar Centre for Security Studies (KCSS) and does not necessarily represent the views of KCSF, SDC, Sweden or Luxembourg.



Katalogimi në botim **(CIP)**

Biblioteka Kombëtare e Kosovës - "Pjetër Bogdani"


396:303.425.6(496.51)(047)

Raporti për vlerësimin bazë të dhunës në baza gjinore në Kosovë :  
perceptimet e komunitetit dhe palëve të interesit / Dea Fetiu. - Prishtinë :  
Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë, 2023. - 25 f. ; 25 cm.

Gratë -- Krimet ndaj tyre  
Testet e opinionit publik -- Raporte -- Kosovë

**ISBN 978-9951-799-82-9**

Aleph [000105455]



ISBN 978-9951-799-82-9



9 789951 799829